AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"

i

## Institucionit të Arsimit të Lartë

## Kolegji Universitar "WISDOM"


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Alba Kruja
2. PhD. Eriona Shtëmbari


Tetor/2020

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Për Programin e studimit: Master i Shkencave në "Administrim Biznesi", ofruar nga Kolegji Universitar "WISDOM"**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Kolegji Universitar "WISDOM" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Ekonomisë |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMASR Nr. 637, datë 05.10.2018 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite / 4 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 6 PAE / 2 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 35 |
| 19 | Komente / të tjera: | |

# PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Përshkrim përmbledhës; 200 – 400 fjalë

Kolegji Universitar "Wisdom" është krijuar nga shoqëria "Wisdom" sh.p.k. mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 672, datë 27.09.2006 për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare, Jopublike "Wisdom University", ndërsa me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 254, datë 27.02.2008, është dhënë leja për zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë në Fakultetin e Drejtësisë dhe atë të Psikologjisë. Me Urdhër Nr. 412 datë 25.08.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës është miratuar riorganizimi i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Wisdom University" me dy fakultete, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike e Shoqërore. Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 540, datë 06.08.2014, është pezulluar përkohësisht veprimtaria e IAL, pezullim i cili është hequr me VKM Nr. 705, datë 29.10.2014. Institucioni është akredituar me kusht me Urdhër Nr. 355 datë 25.09.2015, kushte të cilat janë plotësuar me Urdhër të MAS Nr. 237, datë 09.05.2016 si dhe IAL është riakredituar me VBA Nr. 103 datë 10.11.2017, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe afat vlefshmërie deri më 09.11.2020.

Departamenti i Ekonomisë është një prej tre njësive bazë të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, i cili përbëhet nga 8 pedagogë si Personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 4 janë me tituj e grada shkencore, 1 është Dr. në proces dhe 3 janë me Master Shkencor, kurse 2 janë personel akademik me kontratë (PAK), në përputhje me kërkesat ligjore *(L. 80/2015 - Neni 25, pika 4; Neni 57, pika 1).* Ky departament është njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi", i cili synon përgatitjen e drejtuesve dhe kërkuesve shkencorë apo akademikë në fushën e administrimit të biznesit me pronësi private ose publike. Programi i studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" është licensuar me UMASR Nr. 637 datë 05.10.2018, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), 120 kredite. Ky progam është hartuar dhe ofrohet në përshtatje e zbatim të strategjisë për zhvillim të KUW, statutit si dhe rregullores së tij. Programi Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" është një program që gjendet në disa prej IAL-ve publike dhe private në Shqipëri, megjithatë KUW është përpjekur të sigurojë mbarëvajtjen e këtij programi, duke qenë edhe hera e parë e ofrimit të tij.

Ky është akreditim për herë të parë për këtë program studimi.

**Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Mbështetur në VKM Nr. 109 dhe Manualin për proceset e akreditimit mbi të cilin ASCAL ushtron veprimtarinë e tij, është përcaktuar koha dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Ekspertët përgatitën draft raportin shoqëruar me pyetjet për pjesët që kërkonin qartësim të mëtejshëm dhe/ose verifikim të cilat u kryen gjatë vizitës në IAL në datat 18-19 Qershor, 2020. Gjatë vizitave në IAL u kryen diskutimeve intensive dhe proaktive mes GVJ dhe drejtuesve, stafit akademik, anëtarëve të GVB-së, studentëve, stafit administrativ, etj. Në DVV e përcjellë nga IAL pati disa mangësi, të cilat u kërkuan të plotësohen nga ekspertët, pas vizitës në institucion. Dokumentacioni shtesë i kërkuar pas vizitës në IAL nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 21 Qershor, 2020, përmes sistemit të ASCAL.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit, intervistave, komenteve për DVV, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi". Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga Dr. Alba Kruja dhe PhD. Eriona Shtëmbari. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë program studimi është Msc. Ersi Dako.

Më datë 15.09.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 51/29 Prot., datë 15.09.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, më datë 22.09.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 117 Prot., datë 21.09.2020, përcjell komentet mbi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. GVJ, pasi shqyrtoi me seriozitet komentet e IAL, shprehet si vijon:

## *FUSHA I: OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË "ADMINISTRIM BIZNESI"*

- **Standardi I.3, kriteri 8**

**Komenti në RVJ**

Ndërkohë aktivitetet e pasqyruara në faqen zyrtare të institucionit nuk janë paraqitur në gjuhën angleze. GVJ rekomandon që institucioni të përgatisë, ruajë dhe arkivojë të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze.

**Komenti i Institucionit**

Aktivitetet e pasqyruara në faqen zyrtare të institucionit janë edhe në gjuhën angleze dhe mund të verifikohen lehtësisht tek https://wisdom.edu.al/en. Institucioni ka përgatitur dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën Angleze që ndodhen tek Dosja D e anekseve, në lidhje me programin e studimit MSHAB, ndërsa sa i takon dokumentacionit për të gjithë institucionin, ato ndodhen tek Arkiva. Evidenca mbështetëse: Aneks: https://wisdom.edu.al/en Aneks: Dosja D

**Argumentimi i GVJ**

GVJ konstaton në RVJ se institucioni përgatit dhe arkivon një pjesë të dokumentacionit në gjuhën angleze. Rekomandimi ynë i referohet informacionit dhe aktivitetit lidhur me programin e studimit në fjalë, i cili në faqen web https://wisdom.edu.al/en/faculty-of-economics-and-social-sciences si dhe https://wisdom.edu.al/en/Study-programs është i reflektuar në gjuhën shqipe dhe jo angleze. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

- **Standardi I.6, kriteri 1**

**Komenti në RVJ**

GVJ konstaton se kërkimi shkencor dhe publikimet e stafit janë të pakta gjatë dy viteve të fundit. Ndërkohë për studentët nuk ka evidenca publikimi, përveç pjesëmarrjeve me prezantim në një konferencë studentore të organizuar në institucion.

**Komenti i Institucionit**

Të dhënat e publikimeve të stafit janë pasqyruar në relacionin për të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të Departamentit të Ekonomisë në 5 vitet e fundit, ku nga monitorimi dhe grumbullimi i të dhënave shkencore individuale të personelit akademik nga NJKSHMJ nëpërmjet Formularit të vlerësimit të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike e kërkimore-shkencore, 2014-2019, se aktiviteti kërkimor shkencor i stafit akademik efektiv (PAE) ka pasur zhvillim të konsiderueshëm në drejtimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në aktivitete shkencore kombëtare edhe ndërkombëtare. Konkretisht (PAE) i Departamentit të Ekonomisë ka realizuar 32 botime në revista shkencore të pajisura me ISSN, të cilat kanë akses të hapur në internet, si edhe 8 botime në rang ndërkombëtar nga personeli me kohë të kufizuar (PAK). Po ashtu 10 pedagogë (PAE dhe PAK) kanë marrë pjesë në aktivitete shkencore jashtë vendit, me prezantime të punimeve, si dhe 6 prej tyre janë angazhuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në shkallë institucioni. vlen të përmendet se stafi akademik i departamentit të ekonomisë është rregullisht i angazhuar në aktivitetin shkencor të organizuar nga Departamenti/Fakulteti dhe IAL, për programin e studimit, ku vërehen 13 aktivitete, në të cilat kanë marrë pjesë pedagogët e Departamentit të Ekonomisë. Evidenca mbështetëse: Aneksi 1.17: Relacion nga NJKSHMJ për të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.

**Argumentimi i GVJ**

GVJ në RVJ konstaton se KUW mbështet publikimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të stafit akademik efektiv dhe me kontratë, por ndërkohë, numri i publikimeve të stafit për vitet 2018 dhe 2019 është në rënie, siç evidentohet edhe në Aneksin 2.33. Relacion për të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

***FUSHA II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE***

- **Standardi II.3, kriteri 5**

**Komenti në RVJ**

Megjithatë, GVJ konstatoi gjatë takimit me stafin mësimdhënës, sekretarinë mësimore dhe studentët e programit, se institucioni nuk aplikon kritere specifike dhe të veçanta në përzgjedhjen e kandidatëve dhe sidomos të atyre që vijnë nga fusha të tjera studimi, pasi ata hasin vështirësi në lëndët e avancuara të programit si p.sh. Drejtimi Financiar i Avancuar. GVJ rekomandon vendosjen dhe publikimin e të gjitha informacioneve të nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në funksion të procedurave të përcaktuara në rregulloret e tij.

**Komenti i Institucionit**

Pranimi i studentëve mbështetet në Rregulloren e Programit të Studimit MSHAB, kreu 4, neni 21. Kriteret specifike për pranim miratohen me vendim Senati çdo fillim viti akademik. Kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit janë të përcaktuara në Rregulloren e Transferimeve të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Evidenca mbwshtetwse: Aneksi 1.1: Rregulloren e Transferimeve të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Aneksi 1.2: Rregullore e Programit të Studimit MSHAB; Aneksi 1.3: Vendim i Senatit mbi miratimin e kuotave të pranimit për vitin akademik 2019-2020.

**Argumentimi i GVJ**

Sugjerimi i GVJ i referohet kritereve specifike (jo të përgjithshme) për pranimin e studentëve me përgatitje bachelor nga një fushë tjetër studimi, të cilëve ju mungon baza e njohurive të fushës së biznesit, gjë e cila krijon vështirësi për asimilimin e njohurive të reja në lëndët e avancuara (p.sh. Drejtimi Financiar i Avancuar). Kjo u konstatua dhe u ngrit si shqetësim edhe gjatë takimeve me studentët dhe stafin akademik. Gjithashtu, rregulloret e cituara nuk parashikojnë specifikisht kritere të veçanta për pranimin e studentëve me profil të ndryshëm nga ai i MSHAB (*psh. IAL mund të ofrojë kurse të detyrueshme përgatitore, me njohuritë bazë, të nevojshme për mbarëvajtjen e studentëve të fushave të tjera në këtë program).* Sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

➢ **Standardi II.7, kriteri 3**

**Komenti në RVJ**

Institucioni përfshin studentë të programit në prezantime konferencash studentore dhe projektin kërkimor Erasmus+ "Cultural Studies in Business", por këto nuk kanë përfunduar në një punim shkencor dhe botim.

**Komenti i Institucionit**

Projekti kërkimor Erasmus+, "Cultural Studies in Business", ka konkluduar me një botim, `Conference Prooceedings`, ISBN 978-9928-4356-7-5, 2019, i cili ndodhet në fondin e Bibliotekës si titull fizik, por edhe në linkun https://wisdom.edu.al/image.ashx?i=862538.pdf&fn=revista-2.pdf. Po e dërgojmë në variantin Pdf, bashkëngjitur komenteve. Evidenca. Aneksi 1.4: Kopje e librit Conference Proceeding Cultural Studies in Business.

**Argumentimi i GVJ**

Në këtë kriter, GVJ i është referuar përfshirjes së studentëve të programit MSHAB në kërkimin shkencor. Sipas evidencave mbështetëse, të cituara (Aneksi 1.4) por edhe referuar bisedës me studentët e programit, nuk rezulton që puna (apo prezantimi psh. i studentit E.M) e bërë, të konkludojnë në një botim shkencor. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

***FUSHA IV: BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT***

➢ **Standardi IV.4, kriteri 2.5**

**Komenti në RVJ**

GVJ konstaton se kjo literaturë është relativisht e vjetër. Gjithashtu, ky fakt konstatohet edhe në blerjet e fundit të bibliotekës në vitet 2018-2019-2020, ku një pjesë e literaturës i përket botimeve përpara viteve 2015 dhe 2010. GVJ rekomandon që institucioni të pasurojë literaturën e bibliotekës me nje gamë më të gjerë botimesh bashkëkohore librash në gjuhën shqipe dhe angleze, si libra, revista shkencore e periodikë përtej botimeve institucionale relevante për programin e studimit MSHAB.

**Komenti i Institucionit**

Kolegji Universitar "Wisdom" ka mundësuar blerjen e paketës së Bibliotekës online Proquest me vlerë 4.500.00 USD. Bashkangjitur kontrata e PROQUEST Dt.15.01.2020. Libra online akademikë janë të aksesueshëm tek linku /https://ebookcentral.proquest.com/lib.central/wisdom/. Biblioteka online Proquest ofron përkatësisht 180.716 tituj total libra online akademik, në format PDF, si: Law, Philosophy, 4 Business, Literature, English dhe janë të aksesueshme, për studentë e stafin akademik në disa gjuhë si: anglisht, gjermanisht, frengjisht, italisht etj.. Rreth 136.537 tituj total libra online

akademikë janë të aksesueshëm vetëm në fushën e Economic; Management rreth 129.054 tituj; Business rreth 143.736 tituj; Finance 73.599 tituj. Rreth 256 tituj libra fizik gjithsej, ndodhen në bibliotekë vetëm, për Departamentin Ekonomik. Biblioteka e Kolegjit Universitar "Wisdom" është abonuar në revistat shkencore si: - "The Economist" është revistë shkencore del një herë në javë është në gjuhën angleze. Revista pasqyron realitetet, arritjet, zhvillimet dhe sfidat e reja në fushën e ekonomisë, teknologjisë, financave dhe shoqërisë në botë. - Revista "Harvard Business review" revistë shkencore ekonomike, del çdo javë është në gjuhën angleze. Aneksi 1.5 - Relacion për Bibliotekën KU, WISDOM. Lista e blerjeve 2018-2019-2020. Aneksi 1.6 - Kontratë me ProQuest, Kontratë me platformën online Cobiss.

**Argumentimi i GVJ**

Konstatimi i GVJ-së në këtë kriter i referohet bibliotekës fizike të institucionit, librat e së cilës janë botime të vjetra. Gjithashtu, edhe në blerjet e fundit të bëra nga institucioni, rezulton se një pjesë e literaturës i përket botimeve përpara viteve 2015. Sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

## *FUSHA V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE*

- **Standardi V.2, kriteri 5**

**Komenti në RVJ**

Përveç fletëpalosjes, institucioni nuk ka dorëzuar evidenca të këtyre aktiviteteve. GVJ rekomandon që institucioni të arkivojë dhe analizojë impaktin e aktiviteve institucionale në suksesin e tij.

**Komenti i Institucionit**

Specialistja e Zyrës së Këshillimit të Karriesës dhe Jetës Studentore, mban relacione për të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga institucioni, për këtë bashkëlidhur keni një përmbledhje të raporteve vjetore nga 2017-2020. Evidenca mbështetëse: Aneksi 1.7 - Relacion i plotë i Zyrës së Këshillimit të Karriesës dhe Jetës Studentore për periudhën 2017-2020.

**Argumentimi i GVJ**

Vlerësimi i KUW për këtë kriter është bazuar në raportet dhe evidencat në dispozicion nga dorëzimi i DVV deri në dokumentat shtesë të kërkuara gjatë vizitës ne IAL. Relacioni i përgatitur nga KUW pas vizitës në institucion nuk merret në konsideratë. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

- **Standardi V.4, kriteri 1.2**

**Komenti në RVJ**

Gjatë kontrollit të regjistrit themeltar në zyrën e sekretarisë mësimore gjatë vizitës në institucion, rezulton se numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për vitin akademik

2018-2019 është 21 studentë, nga ku 4 janë ç'regjistruar, ndërsa në vitin akademik 2019-2020 është 18 studentë, nga ku 3 janë ende pa numër matrikullimi. Për këta të fundit ka komunikim me QSHA për pajisjen e tyre me numër matrikullimi dhe janë në pritje.
Ndërkohë, numri i studentëve të paraqitur në aneksin 2.20, nuk përputhet për vitin akademik 2018-2019 pasi rezulton të jetë 18. GVJ rekomandon që institucioni të mbajë dhe raportojë statistika të sakta për numrin e studentëve të regjistruar dhe të larguar.

**Komenti i Institucionit**

Sekretaria ka komunikuar me QSHA për pajisjen e këtyre studentëve me numër matrikullimi dhe ishte në pritje. Për sa kohë nuk dispononte një përgjigje, institucioni ishte i detyruar t'i mbante të regjistruar studentët në fjalë, përveç rastit kur vetë studentët do të kërkonin ç'regjistrimin e tyre nga programi, siç ka ndodhur tashmë me tre prej tyre, të cilët aktualisht janë çregjistruar. Evidenca mbështetëse: Aneksi 1.8. Lista e çregjistrimeve të studentëve në MSHAB.

**Argumentimi i GVJ**

Rekomandimi në raport i GVJ lidhet me mospërputhjen në numrin e studentëve për vitin akademik 2018-2019 dhe jo për vitin akademik 2019-2020. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

## *FUSHA VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE*

- **Standardi VI.1**

**Komenti në RVJ**

GVJ rekomandon a) përfshirjen e ekspertit të jashtëm në këtë njësi b) si dhe një anëtari nga administrata e institucionit për të siguruar një këndvështrim më gjithëpërfshirës, objektiv dhe efektiv të sigurimit të cilësisë në institucion.

**Komenti i Institucionit**

Referuar rekomandimit a) mbi përfshirjen e një eksperti të jashtëm në NJSBC, ju bëjmë me dije se bazuar në Nenin 27 (NJSBC) të Statutit të KUW thuhet se: mund të bëjë pjesë dhe 1 (një) anëtar në cilësinë e ekspertit të jashtëm. Dëshirojmë t`ju vëmë në dijeni se deri më tani në proceset e akreditimit të mëparshme të kaluara në nivel institucional apo programor nuk na ka ardhur asnjë rekomandim për përfshirjen e një eksperti të jashtëm. Ndaj, referuar rekomandimit tuaj, i cili përputhet edhe me statutin e KUW nga ana e autoriteteve drejtuese do të shihet mundësia për ta përfshirë edhe një ekspert të jashtëm në NJSBC. Ndërsa referuar rekomandimit b) për përfshirjen e një anëtari nga administrata e institucionit, e vlerësojmë rekomandimin tuaj por duke u bazuar po në nenin 27, të Statutit të KUW thuhet se: Anëtarët e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë emërohen nga Senati Akademik, nga radhët e personelit akademik, sipas propozimeve të bëra nga njësitë kryesore, ndaj vërejmë së është e

pamundur të përfshihet një anëtar nga administrata pasi do të binte ndesh me këtë nen të Statutit të KUW. (Dokument mbështetës Neni 27, Statuti i KUW)

**Argumentimi i GVJ**

Lidhur me pikën a të komentit, institucioni ka shprehur dakordësinë se në të ardhmen do të shihet mundësia për përfshirjen e një eksperti të jashtëm. Ndërsa lidhur me pikën b të komentit, GVJ do ta marrë në konsideratë, duke qenë se përfshirja e stafit administrativ në NJSBC bie ndesh me statutin institucional. Kjo pikë është reflektuar edhe në RVJ, duke hequr në këtë rekomandim pjesën referuar administratës.

- **Standardi VI.2**

**Komenti në RVJ**

a) Referuar takimit me NJSBC si dhe dokumentacionit të konsultuar, ekspertët konstatojnë që njësia përdor një metodologji deskriptive të vlerësimit, të ecurisë dhe mbarëvajtjes së programit të studimit, ndërkohë GVJ rekomandon që elementët e përdorur në pyetësorët drejtuar si studentëve, ashtu edhe stafit të programit, duhen kuantifikuar, në mënyrë që njësia të mund të dalë në konkluzione të sakta dhe të pa manipulueshme. b) Gjatë takimit me stafin akademik të programit gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatuan hezitime të stafit akademik lidhur me metodologjinë përshkruese dhe jo të kuantifikuar të raportit të përgatitur nga njësia. Gjithashtu ekspertët rekomandojnë që këto raporte të përfshijnë edhe rezultatet e pritshme dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.

**Komenti i Institucionit**

a) Referuar këtij rekomandimi ju bëjmë me dije se bazuar në nenit 103 pika 3 të Ligji AL 80/2015, në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, Institucioni ynë organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi; si dhe pikës nr 3, neni 27 të Statutit të KUW ku thuhet se: 3. Njësia ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit, ajo organizon punën në bashkëpunim me departamentet dhe të gjitha raportet e hartuara nga NJSBC mbi pyetësorët bazohen mbi përpunimin e kuantifikuar të të dhënave dhe jo thjesht përshkrimin teorik të tyre me qëllim që konkluzionet të jenë sa më të sakta. *Aneksi 1.9 Relacion semestral e pyetësorëve të studentëve. Aneksi 1.10 Raport vjetor i NJSBC në lidhje me vleresimin e pedagogut në bazë të pyetësorit për vitin akademik 2018-2019.* Dëshirojmë t`ju vëmë në dijeni se pyetësorët janë dinamike, dhe miratohen çdo vit akademik duke i pasuruar me elementë të rinj bazuar edhe në metodologjitë e vlerësimit, përfshirë edhe shkallën Likert. *Aneksi 1.11 - Vendimi Nr. 111 Prot. 23.10.2015 për miratimin e pyetësorit të studentëve të ri të paraqitur nga grupi i punës, bashke me pyetësorin e ndryshuar. Aneksi 1.12 - Vendimi me Nr. 59 Prot të datës 14.11.2019 mbi miratimin e pyetësorëve për vitin akademik 2019-2020.* Në vazhdimësi rekomandimet tuaja do të merren në konsideratë.

b) Referuar këtij rekomandimi ju bëjmë me dije se bazuar në rezultatet e përftuara nga përpunimi i pyetësorëve nga ana e stafit akademik nuk na është adresuar ky hezitim me qëllim që ne si Njësi të fillonim punën për ndryshimin e metodologjisë së përpunimit të të

dhënave. Rrugët sesi mund të adresohen janë disa duke nisur qysh nga: Raporti i Pyetësorit të Pedagogut ku në fund të tij është parashikuar një rubrikë e titulluar "Mendime dhe sugjerime të tjera eventuale" në të cilën të gjithë anëtarët e stafit akademik janë të lirë të shprehin opinionet e tyre (Bashkëngjitur formati i pyetësorit të pedagogut) dhe deri tek intervistat informale, gjatë të cilave ata mund të shprehin sugjerimet e tyre përkatëse në lidhje me këtë aspekt. Ndaj për ta konfirmuar po ju bashkëngjisim në këtë *argument dy raporte të përpunimit të pyetësorëve të pedagogëve.* Lutemi të merret në konsideratë fakti se programi është në vitin e dytë të zhvillimit të tij. NjSBC angazhohet që në vazhdim të marrë në konsideratë ashtu si ka vepruar deri më tani rekomandimet e ndryshme që mund të vijnë nga stafi akademik në drejtim të përmirësimit të standardeve të cilësisë në IAL.

**Argumentimi i GVJ**

Rekomandimi i pasqyruar në RVJ për këtë standard lidhet me metodologjinë e vlerësimit të pyetësorëve, e cila është deskriptive, dhe jo pyetjet e pyetësorit. GVJ konstaton sërish se metodologjia e përdorur nga NJSBC në hartimin e raporteve (Aneks 2.32. Relacion semestral për pyetësorin e studentëve dhe Aneks 2.26. Raport vjetor i NJSBC në lidhje me vlerësimin e pedagogut në bazë të pyetësorit për vitin akademik 2018-2019), nuk janë pasqyruar të dhëna kuantitative mbi të cilat janë bërë konkluzionet e njësisë. Gjithashtu GVJ vë theksin sërish në shqetësimin e pasqyruar nga stafi akademik gjatë vizitës në institucion rreth kësaj metodologjie përshkruese të përdorur nga njësia. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

- **Standardi VI.3**

**Komenti në RVJ**

GVJ është i mendimit se: a) NJSBC duhet të informojë paraprakisht stafin akademik përpara vizitës së kontrollit në auditor, si dhe b) komisioni i kontrollit duhet të përbëhet nga ekspertë të fushës, për të arritur një vlerësim objektiv dhe konstruktiv të metodologjisë e cilësisë së përdorur nga pedagogu në mësimdhënie.

Por, në të njëjtën kohë, c) GVJ rekomandon që institucioni të konsultohet edhe me punëdhënësit dhe biznese të ndryshme lidhur me nevojat e tregut të punës si dhe vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit.

**Komenti i Institucionit**

Referuar rekomandimit a) na lejoni t`ju sqarojmë si vijon: Në nisje të vitit akademik NjSBC mblidhet dhe në kuadër të realizimit të funksioneve të saj referuar LAL si dhe akteve rregullatore të KUW dhe krahas të tjerash miraton edhe një Kalendar të Kontrollit të Cilësisë (hartohet nga anëtarët e NjSBC sipas programeve të studimit që mbulojnë në bashkëpunim me Departamentet). Në procesin e kontrollit merr pjesë edhe një anëtar nga Komisioni për garantimin e Standarteve të Cilësisë ose Përgjegjësi i Departamentit. Ndaj logjikisht kontrolli nuk ka për qëllim befasinë, por shkëmbimin e përvojave më të mira dhe evidentimin e mangësive, aspekteve pozitive, respektimin e planit kalendar dhe syllabusit, angazhimin e studentëve në orën e mësimit etj,. Kalendarët e kontrollit janë një mekanizëm i përdorur ndër vite dhe tashmë njihet dhe kuptohet si proces nga të gjithë anëtarët e stafit akademik që nuk

ka për qëllim befasinë sesa mundësinë për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe shkëmbimin e përvojave më të mira (Bashkëngjitur model kalendari kontrolli). Njëkohësisht ju informojmë se liria ekonomike gëzon një mbrojtje të veçantë në KU Wisdom, duke u parashikuar në nenin 8 të Statutit, ashtu dhe në dokumentin Politikat e Garantimit të Cilësisë, miratuar nga Komisioni i Garantimit të Cilësisë Nr. 411, datë 11.10.2019, faqe 3. Aneksi 1.13 Politikat e Garantimit të Cilësisë.

*Referuar rekomandimit b) komisioni i kontrollit duhet të përbëhet nga ekspertë të fushës, për të arritur një vlerësim objektiv dhe konstruktiv të metodologjisë e cilësisë së përdorur nga pedagogu në mësimdhënie.* Lidhur me këtë pikë na duhet të theksojmë se në procesin e kontrollit nuk marrin pjesë vetëm anëtarët e NJSBC por edhe një anëtar i Departamentit përkatës ose nga Komisioni për garantimin e Standardeve të Cilësisë për të realizuar sa më profesionalisht procesin e kontrollit nga ekspertë jo vetëm teknikë por edhe akademik të fushës së studimit të pedagogut që i nënshtrohet kontrollit.

*Referuar pikës c) ku GVJ rekomandon që institucioni të konsultohet edhe me punëdhënësit dhe biznese të ndryshme lidhur me nevojat e tregut të punës si dhe vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit.* KUW konsultohet me punëdhënës dhe biznese të ndryshme në vazhdimësi. Kjo bëhet si në drejtim të njohjes së nevojave të tregut të punës ashtu edhe të vlerësimit të programeve të studimit. Institucioni ka realizuar me partnerët studime tregu me qëllim që të rritet cilësia e programeve të studimit që ofrohen. Krahas kësaj në KUW pikërisht për të realizuar këtë funksion është ngritur dhe funksionon Bordi Këshillimor i Biznesit me përfaqësues pikërisht nga partnerët, bota e biznesit dhe punëdhënës të cilët japin këshillat e tyre si dhe bëhen zëri i nevojave të tregut në programet e studimit që ofrohen në IAL-në tonë. *Aneksi 1.14 Vendimi mbi ngritjen dhe përbërjen e Bordit Këshillimor të Biznesit.*

**Argumentimi i GVJ**

GVJ merr në konsideratë komentet e institucionit dhe reflekton ndryshimin në RVJ, duke hequr konstatimet/rekomandimet e mësipërme. Ndryshimi përkatës është pasqyruar edhe në standardin III.1, kriteri 2. Gjithashtu, si rezultat i reflektimit të sa më sipër, ndryshon edhe vlerësimi për këtë standard nga "përmbushet kryesisht" në "përmbushet plotësisht".

- **Standardi VI. 4**

**Komenti në RVJ**

GVJ rekomandon a) përfshirjen e një eksperti të jashtëm si dhe një anëtari nga stafi administrativ në këtë njësi. Gjithashtu, pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. b) Rregullorja e NJSBC përcakton përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë në tërësinë e tyre, por mungon një dokument i cili specifikon përgjegjësitë e secilit prej anëtarëve të njësisë. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. c) Por, siç u përmend

edhe më sipër, GVJ rekomandon që njësia të përdorë instrumenta kuantitativë nëpërmjet pyetjeve me shkallë likerti në mbledhjen e të dhënave për vlerësimet në mënyrë që raportimi i tyre të jetë sa më transparent dhe i pamanipulueshëm.

**Komenti i Institucionit**

Shih standartin VI.1.

Referuar pikës b) Rregullorja e NJSBC përcakton përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë në tërësinë e tyre, por mungon një dokument i cili specifikon përgjegjësitë e secilit prej anëtarëve të njësisë, na lejoni t`ju parashtrojmë se NJSBC është organ kolegjial pjesë e strukturës akademike të KUW dhe si i tillë funksionon në kolegjialitet dhe marrja e vendimeve bëhet në mënyrë kolektive nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Për sqarim mund ti referoheni Nenit 25 të Rregullores së NjSBC "Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të NjBSC" ku thuhet se: *Anëtarët e NjSBC pranë Kolegjit Universitar "Wisdom" kanë të drejta dhe detyrime të njëjta si kryetari i NjBSC.* Në funksion të realizimit të funksioneve të tyre ata duhen të angazhohen maksimalisht që të zbatojnë udhëzimet që dalin si domosdoshmëri gjatë realizimit të detyrave të ngarkuara nga drejtuesit e Kolegjit. Pra ritheksojmë se përgjegjësitë e tyre, të drejtat dhe detyrimet janë të njëjta me ato të Kryetarit të NjSBC. Aneksi 1.15: Rregullore e NjSBC.

Referuar pikës c) ju bëjmë me dije se bazuar në LAL në RSH, më konkretisht nenit 103 pika 1: Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë; si dhe pikës nr 3, neni 27 të Statutit të KUW ku thuhet se: 3. Njësia ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit, ajo organizon punën në bashkëpunim me…Referuar këtyre pikave mund të konstatojmë se nuk parashikohen domosdoshmërisht elementet kuantitative por është vetë institucioni përgjegjës për hartimin e instrumenteve. Gjithsesi na duhet t`ju bëjmë me dije se të gjitha raportet e hartuara nga NJSBC bazohen mbi përpunimin e kuantifikuar të të dhënave dhe jo thjesht përshkrimin teorik të tyre me qëllim që konkluzionet të jenë sa më të sakta. *Aneksi 1.16 Raport vjetor të NjSBC për vitin akademik 2018-2019.* Dëshirojmë t`ju vëmë në dijeni se deri më tani në proceset e akreditimit të mëparshme të kaluara në nivel institucional apo programor nuk na ka ardhur asnjë rekomandim për kuantifikimin e instrumenteve apo realizimin e pyetjeve në shkallë likerti. Në vazhdimësi rekomandimet tuaja do të merren në konsideratë.

**Argumentimi i GVJ**

Komenti i institucionit pranohet për pikën e parë pasi përfshirja e stafit administrativ në NJSBC bie ndesh me statutin institucional. Sa më sipër, është reflektuar në RVJ duke hequr rekomandim përkatës.

Gjithashtu, pranohet komenti për pikën b, ku institucioni i referohet Nenit 25 të Rregullores së NjSBC *"Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të NjBSC"*, ku thuhet se: *"Anëtarët e NjSBC pranë Kolegjit Universitar "Wisdom" kanë të drejta dhe detyrime të njëjta si kryetari i NjBSC"* dhe është reflektuar në raport duke hequr konstatimin përkatës.

Ndërkohë, komenti i pikës c nuk pranohet, pasi institucioni nuk disponon evidenca lidhur me implementimin e tyre. GVJ konstaton sërish se në Raportin vjetor të NJSBC për vitin akademik 2018-2019, nuk janë pasqyruar të dhëna kuantitative mbi të cilat janë bërë konkluzionet e njësisë.

- **Standardi VI.5**

**Komenti në RVJ**

a) Ekspertët konstatojnë se KUW ka të publikuar në faqen e tij web statutin, rregulloren dhe raportin vjetor të NJSBC për vitin akademik 2018-2019. Raporti i NJSBC është hartuar duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Por, në këtë raport, ekspertët nuk hasën një plan masash që adresojnë dhe synojnë përmirësim të mangësive dhe dobësive institucionale apo të programit në fjalë. b) Në të njëjtën kohë GVJ nuk evidenton raporte vlerësuese për përmirësime të problematikave të mëparshme qoftë të programit apo institucionit. GVJ rekomandon që institucioni të hartojë raporte në bazë programi të cilat të bëhen publike. Në këto raporte duhet të përfshihen mangësitë dhe dobësitë e evidentuara, plan programi i cili adreson përmirësimin e tyre si dhe gjithashtu të raportojë vlerësimet e përmirësimit të këtyre mangësive dhe dobësive të evidentuara në periudhat e ardhshme. KUW duhet të marrë masa për të siguruar efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, dhe impakti i tyre të jetë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.

**Komenti i Institucionit**

Referuar pikës a) na lejoni t`ju parashtrojmë se bazuar në Nenin 26 të rregullores së NjSBC Raporti periodik i vetëvlerësimit, pika 2 ku theksohet se raport duhet të përfshijë jo vetëm përshkrimin por edhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë. NJSBC si strukturë nuk harton plan masash në një raport të tillë por del me rekomandime të cilat ju mund ti gjeni nqs hulumtoni 10 psh në faqet: 11-12-23-24-25-26. Krahas kësaj ju rikujtojmë së programi përkatës që po i nënshtrohet këtij procesi akreditimi është ende në vitin e dytë të implementimit. Me diplomimin e brezit të parë në do mundemi bazuar edhe në faktorë që kanë lidhje me suksesin e të diplomuarve tanë në tregun e punës të evidentojmë mangësi apo përmirësime të mundshme me qëllim rritjen e standarteve të cilësisë së programeve të ofruara në institucionin tonë tashmë të konsoliduar prej vitesh. Referuar po Nenit 26 të rregullores së NjSBC, pika 3 ku parashikohet se: Raporti i vetëvlerësimit prezantohet në Senatin e Kolegjit Universitar "Wisdom" i cili e analizon, e diskuton dhe përcakton drejtimet kryesore për zgjidhjen e problemeve dhe sugjerimeve të paraqitura në raport dhe që dalin edhe nga diskutimet e anëtareve të Senatit, ju parashtrojmë se është Senati dhe jo NjSBC që përcakton problemet dhe adreson zgjidhjen e tyre dhe jo NJSBC e cila del me rekomandime dhe ju vë në dispozicion njësive kryesore dhe bazë të dhënat e nevojshme të cilat këto të fundit i përkthejnë në masa konkrete për përmirësimin e cilësisë. Referuar pikës b) na lejoni tju parashtrojmë se në raportin vjetor të NJSBC 2018-2019, por edhe në raporte të tjera të njësisë ndër vite janë adresuar problematika të ndryshme (referohu raportit vjetor f.11) janë parashtruar problematika apo pika të dobëta të cilat janë bërë objekt i diskutimeve në Departamente si njësi bazë (një mbledhje e departamentit të ekonomisë, protokolli i

diskutimit mbi problematikat e dala nga raporti vjetor i NjSBC) dhe janë marë masa në drejtim të përmirësimit të tyre.

Përveç sa sipër ju bëjmë me dije se ekspertët në RVJ kanë dhënë dy vlerësime të ndryshme në lidhje me NJSBC, konkretisht: *Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira,* ku roli i NJSBC është kryesor, vlerësimi për këtë standard *është "Përmbushet plotësisht"*. Ndërsa Fusha VI – Sigurimi i cilësisë së programit të studimit "Përmbushet pjesërisht".

**Argumentimi i GVJ**

Komentet e institucionit pranohen pjesërisht dhe janë reflektuar ndryshimet përkatëse në këtë standard. Si rezultat i reflektimit të ndryshimeve, ndryshon edhe vlerësimi për standardin nga "përmbushet pjesërisht" në "përmbushet kryesisht".

Konstatohet se NJSBC, në raportin vjetor, ka adresuar problematika të ndryshme, por institucioni nuk disponon evidenca lidhur me një plan masash që adresojnë dhe synojnë përmirësim të mangësive dhe dobësive institucionale apo të programit si dhe raporte vlerësuese për përmirësime të problematikave të mëparshme.

Lidhur me komentin e IAL se programi është ende në vitin e dytë të implementimit, GVJ dëshiron të evidentojë se ky fakt duhet të shihet si arsyeja dhe qëllimi pse akreditimi kryhet pikërisht përpara diplomimit të brezit të parë të studentëve, për të vlerësuar efiçencën dhe efektivitetin e një programi studimi dhe njëkohësisht për të evidentuar mangësi të cilat duhen korigjuar në ofrimin e programit për kohortën e dytë.

Lidhur me komentin për dhënien e dy vlerësimeve të ndryshme për NJSBC, GVJ shprehet se ky ndryshim në vlerësim vjen si pasojë e analizimit dhe vlerësimit të kritereve të ndryshme në secilin standard. Standardi III.2 i referohet organizimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, proces për të cilin GVJ nuk konstatoi mangësi organizative. Ndërkohë, Standardi VI.5, i referohet një aspekti komplet tjetër, ku GVJ ka vënë në dukje mangësitë e konstatuara (referuar dokumentave në dispozicion, por edhe vizitës në institucion) lidhur me NJSBC, të analizuara dhe komentuara përgjatë gjithë fushës VI.

Gjithashtu, si rezultat i ndryshimit të vlerësimit për dy nga standardet e kësaj fushe, vlerësimi për fushën VI ndryshon nga "përmbushet pjesërisht" në "përmbushet kryesisht.

**Shënim:** Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë e kushteve të jashtëzakonshme të pandemisë së COVID-19. Komunikimi me IAL është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132, datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91, dt. 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190, datë 19.03.2020.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"**

## I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË "ADMINISTRIM BIZNESI"

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ofron program studimi "Master i shkencave" që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.<br><br>**Kriteri 2.** Programi i studimit "Master i shkencave" synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.<br><br>**Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.<br><br>**Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave" hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.<br><br>**Kriteri 5.** Programi i studimit "Master i shkencave" krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor | Kolegji Universitar "Wisdom" (KUW) është institucion i arsimit të lartë që vepron në fushën e drejtësisë, ekonomisë dhe të shkencave shoqërore, si dhe të kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar, veprimtari krijuese, shërbime, etj (Aneks 1.01, neni 1).<br>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi (MSHAB) i ofruar nga Departamenti i Ekonomisë pranë KUW është i licencuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë Nr. 637 datë 05.10.2018, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), 120 kredite.<br>Misioni i këtij programi është:<br>1. Përgatitja e drejtuesve të subjekteve publike dhe private në të tëra nivelet.<br>2. Përgatitja e kërkuesve shkencorë dhe akademike në fushën e biznesit dhe administrimit në të tëra nivelet, përgatitja e specialistëve me njohuri të thella shkencore në fushën e biznesit dhe administrimit, përgatitja e drejtuesve dhe specialistëve me njohuri interdisiplinare në fushën e biznesit dhe administrimit, përgatitja e konsulentëve të nivelit të lartë në fushën e biznesit dhe administrimit.<br>3. Përgatitja e kualifikimit shkencor në Programin e Studimit Master i Shkencave, studime doktorate etj. (Aneks 3.01, neni 6)<br>Ky mision është në përputhje me misionin institucional të KUW i shprehur në statutin e tij neni 4.2: *"KUW ka për mision zhvillimin e arsimit dhe shkencës, në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për zhvillimin e ekonomisë, për rritjen e mirëqënies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente".*<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU Wisdom.<br>Aneks 2.04 Plani strategjik për zhvillimin e departamentit (në nivel akademik, financiar, burimesh njerëzore etj).<br>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i |

| | |
|---|---|
| | Shkencave në Administrim biznesi;<br>Aneks 3.04 Plani mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim biznesi".<br>Temat e diplomave, udhëheqësit dhe fusha e tyre e studimeve. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit MSH është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | KUW synon të bëhet qendra e arsimit universitar, pasuniversitar, e kërkimit dhe e trajtimit për përgatitjen profesionale dhe shkencore të specialistëve të fushës së drejtësisë, ekonomisë dhe psikologjisë (Aneks 1.03, fq. 3). |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Një ndër qëllimet e KUW e përcaktuar në Statutin e tij është:<br>- Të kryejë studime dhe kërkime shkencore në fushën e shkencave jurisike, ekonomike dhe të psikologjisë dhe jo vetëm;<br>- Të kryejë kualifikimin shkencor pasuniversitar, për juristë, psikologë, ekonomistë dhe persona të fushave të tjera në programe studimi ndërdisiplinore;<br>- Të vendosë një lidhje të fortë dhe funksionale me komunitetin në përgjithësi dhe veçanërisht me administratën shtetërore dhe komunitetin e biznesit nëpërmjet arritjes së një partneriteti të përhershëm e shumë funksional (Aneks 1.01, neni 4.6).<br>GVJ konstaton se programi i studimit MSHAB i ofruar nga Departamenti i Ekonomisë është hartuar dhe ofrohet në përshtatje e zbatim të strategjisë për zhvillim të KUW, statutit si dhe rregullores së tij.<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU Wisdom.<br>Aneks 1.02 Rregullore e KU Wisdom.<br>Aneks 1.03 Plani strategjik i zhvillimit I KU Wisdom.<br>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim biznesi. |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Bazuar në dokumentat strategjike të institucionit si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit MSHAB, i ofruar nga Departamenti i Ekonomisë, ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademik të institucionit.<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU Wisdom. |

| | |
|---|---|
| | Aneks 1.02 Rregullore e KU Wisdom.<br>Aneks 1.03 Plani strategjik i zhvillimit i KU Wisdom.<br>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimi të ciklit të dytë master i shkencave në administrim biznesi.<br>Aneks 3.04 Plani mësimor i programit të ciklit të dytë "master i shkencave" në "administrim biznesi". |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave" hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit | Referuar dokumentave institucionale, GVJ konstaton se programi i studimit MSHAB është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe interesit kombëtar, por gjithashtu *rekomandon përdorimin e literaturës më të fundit për të ndjekur trendet globale të zhvillimit.*<br><br>Aneks 2.04 Plani strategjik për zhvillimin e departamentit (në nivel akademik, financiar, burimesh njerëzore etj).<br>Aneksi 2.41 Relacion për bibliotekën KU Wisdom, lista e blerjeve 2018-2019-2020. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.3**<br>**Programi i studimit "Master i shkencave" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit "Master i shkencave" ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. | Programi i studimit MSHAB i ka objektivat për formimin e studentëve të përcaktuar qartë. Këto objektiva përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që studenti përfton në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit dhe kërkesat e tregut të punës.<br><br>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimi të ciklit të dytë master i shkencave në administrim biznesi.<br>Aneks 3.15 Suplementi i diplomës "Master i Shkencave" në "Administrim biznesi" Nr. Prot 6741, datë 13.04.2018. |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Institucioni disponon një punim të titulluar "Studim i tregut të punës para hapjes së programit MSHBA". *Metodologjia mbi të cilën është ndërtuar ky punim nuk arrin të pasqyrojë problematikat dhe nevojat e bizneseve të vendit, pasi nuk janë reflektuar evidenca nga të dhëna parësore apo dytësore të mbledhura nga tregu.* Gjatë vizitës në institucion, në bisedat me GVB dhe stafin akademik, u theksua se, përpara hapjes së programit të studimit, stafi i Departamentit të Ekonomisë ka kryer takime me biznese të ndryshme në vend rreth nevojave që ato kanë, *por rezultatet e këtyre takimeve nuk janë të reflektuara në këtë punim.*<br>*GVJ rekomandon që institucioni të kryejë një studim tregu të* |

| | |
|---|---|
| | *punës të mirëfilltë, në të cilin të reflektohen me evidenca nevojat konkrete të bizneseve në vend si dhe kërkesat e studentëve për fushën e thellimit të njohurive të tyre të mëtejshme për të patur aftësi konkuruse në treg.*<br>Duke qenë se këtë vit akademik diplomohen studentët e parë të këtij programi, institucioni nuk ka mundur të kryejë studime mbi punësimin e të diplomuarve.<br><br>Aneks 3.02 Studimi i tregut të punës para hapjes së programit "Master i Shkencave" në "Administrim biznesi". |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese të programit të paraqitura në suplementin e diplomës. *Por, hartimi i këtij programi, është bazuar në një studim tregu të ndërtuar mbi një metodologji që nuk mund të identifikojë nevojat në dije, aftësi, shkathtësi e kompetenca të tregut e të lehtësojë punësimin e studentëve. GVJ rekomandon që institucioni të implementojë një analizë të tregut të punës nëpërmjet kërkimit primar.*<br><br>Aneks 3.02 Studimi i tregut të punës para hapjes së programit "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi".<br>Aneks 3.15 Suplementi i Diplomës "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi" Nr. Prot 6741, datë 13.04.2018. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. | Në RVB raportohet se programi i studimit MSHAB përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara në SHBA me programin online të Illinois University; në Francë, me programin MBA të Cass European Institute of Management Studies; në Kaliforni me programin e Standford University; në New Jersey me programin part-time MBA me fokus në financë të Rutgers University.<br>Ndër këto institucione një është online, dhe një institucion part-time me fokus në financë. *GVJ sugjeron që institucioni të ketë në fokus përafrimin me programe studimi në kohë të plotë dhe vetëm në fushën e administrim biznesit.*<br><br>RVB Master i Shkencave AB. |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane. | Programi i studimit MSHAB është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së. Programi vlerësohet me kredite sipas Sistemit Europian të Grumbullimit dhe Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe diploma në përfundim të programit të studimit u shoqërohet studentëve me suplementin e diplomës.<br>Aneks 3.05 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi".<br>Aneks 3.15 Suplementi i Diplomës "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi" Nr. Prot 6741, datë 13.04.2018.<br>Aneks 3.16 Modeli i Diplomës"Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi". |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Programi i studimit "Master i shkencave" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. | Programi i studimit MSHAB përfshin zhvillimin e praktikës profesionale, të cilës i ka akorduar një ngarkesë prej 12 ECTS (10% të krediteve totale) dhe ka marrëveshje me institucione publike dhe private për të mundësuar zhvillimin e saj.<br>Aneks 2.22 Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale.<br>Aneks 3.04 Plani mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi". |
| **Kriteri 7.** Në programin e studimit "Master i shkencave", duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit. | Në programin e studimit MSHAB, përveç literaturës shtesë së rekomanduar në syllabus dhe rasteve studimore, *nuk rezulton përfshirje e moduleve, lëndëve apo ndonjë elementi tjetër në gjuhën angleze. Me qëllim thithjen e studentëve të huaj si dhe rritjen e mobilitetit në kuadër të ndërkombëtarizimit institucional, GVJ sugjeron integrimin e më tepër elementëve apo zhvillimin e ndonjë lënde në gjuhën angleze.*<br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II). |
| **Kriteri 8.** Për programin studimit "Master i shkencave", institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze | GVJ konstaton se një pjesë e dokumentacionit institucional përgatitet dhe arkivohet në gjuhën angleze. *Ndërkohë aktivitetet e pasqyruara në faqen zyrtare të institucionit nuk janë paraqitur në gjuhën angleze.*<br>*GVJ rekomandon që institucioni të përgatisë, ruajë dhe arkivojë të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze.*<br>https://wisdom.edu.al/en |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi I.4**<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Programi i studimit MSHAB ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë, pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.<br>Në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore për vitin akademik 2019-2020 janë të angazhuar 22 personel akademik efektivë (PAE) dhe 5 me kontratë (PAK). Të tre njësitë pranë këtij fakulteti përmbushin kriteret e PAE si më poshtë:<br>- Departamenti i Psikologjisë ka 7 anëtarë PAE, ndër të cilët 5 janë me gradë shkencore /titull akademik;<br>- Departamenti i Ekonomisë ka 8 anëtarë PAE, ndër të cilët |

| | |
|---|---|
| | 4 janë me gradë shkencore /titull akademik;<br>- Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë ka 7 anëtarë PAE, ndër të cilët 5 janë me gradë shkencore/titull akademik.<br><br>Aneksi 2.16 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.<br>Lista emërore e stafit PAE dhe PAK për programin. |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | KUW vepron brenda kornizave ligjore dhe respekton ligjin e arsimit të lartë në fuqi (L. 80/2015) si edhe përcaktimet statutore.<br><br>Programi i studimit MSHAB është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave Ekonomisë dhe Shoqërore, si dhe i shërben misionit të tij. Gjithashtu programi në fjalë është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Ekonomisë dhe në shërbim të misionit të tij. |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje | Ky program është në përputhje me nivelin 7 të Kornizës Evropiane dhe Shqiptare të Kualifikimit.<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU Wisdom.<br>Aneks 1.02 Rregullore e KU Wisdom.<br>Aneks 1.03 Plani strategjik i zhvillimit i KU Wisdom.<br>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimi të ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim biznesi.<br>Aneks 3.04 Plani mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim biznesi". |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit MSHAB, KUW ka të përcaktuar në rregulloret e brendshme si institucionale ashtu edhe të Departamentit të Ekonomisë dhe të programit të studimit MSHAB ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive midis njësive të ndryshme e personelit administrativ dhe akademik. *Në një pjesë të rregulloreve, GVJ evidenton se ka probleme drejtshkrimore dhe teknike në të shkruar, si p.sh. Rregullorja e Programit të Studimit të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.* |





| | |
|---|---|
| | Nga dokumentacioni i dorëzuar, konstatohet një analizë vjetore e ecurisë në rang fakulteti, dhe një relacion jo i detajuar i koordinatores së programit. *GVJ sugjeron ndërmarjen e analizave të detajuara dhe të integruara të arritjeve dhe përmbushjeve të objektivave edhe në rang departamenti apo programi.*<br><br>Aneks 1.02 Rregullore e KU Wisdom.<br>Aneks 2.05 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.pdf<br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti).<br>Aneks 2.24 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.<br>Aneks 2.25 Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit; Detyrat e koordinatorit të programit.<br>Aneks 2.27 Analizë Vjetore e Fakultetit përgjegjës (vjetore periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.<br>Aneks 2.33 Relacion për dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.<br>Aneks 2.57 Proces verbal mbledhjesh departamentit për vendime të MSHAB.<br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Relacion i analizes vjetore nga koordinatorja e programit. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.<br><br>**Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit "Master i shkencave", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron. | Institucioni ka vendosur marrëdhënie të ndryshme bashkëpunimi në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor të programit MSHAB. KUW bashkëpunon me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si p.sh. Universiteti i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti La Sapienza në Itali, etj. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme për të realizuar praktikat profesionale të studentëve, ndër të cilat vlen të përmenden marrëveshjet me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Irisoft Education, R&T Group, Nettrade Albania, etj.<br><br>Këto marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe aktorë të biznesit janë në mbështetje të realizimit të veprimtarive të përbashkëta kërkimore shkencore si dhe realizimit të praktikave profesionale.<br><br>Aneks 2.22 Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve. | KUW ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe të kërkimit shkencor si Universiteti La Sapienza në Itali në kuadër të projektit Erasmus+ Cultural Studies in Business. Pjesë e aktiviteteve të financuara nga projekti kanë qenë pjesëmarrja në trajnime e studentëve apo pedagogëve të institucionit. *GVJ rekomandon që këto bashkëpunime të rriten në numër dhe të shtrihen me fokus mobiliteti të personelit akademik për shkëmbim të eksperiencave në mësimdhënie dhe të studentëve.* |

| | |
|---|---|
| | Aneksi 2.44 Marrëveshje bashkëpunimi me ERASMUS. |
| **Kriteri 6.** Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit | Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomisë dhe Shoqërore harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në rang fakulteti. *GVJ rekomandon që këto raporte të përgatiten edhe në rang departamenti apo programi.*<br><br>Aneksi 2.24 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi I.6**<br>**Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve. | KUW mbështet publikimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të stafit akademik efektiv dhe me kontratë nëpërmjet revistës Wisdom me ISSN: 2410-8472. Institucioni ka financuar edhe publikimin e librit Manaxhim Total i Cilësisë, i cili përdoret si literaturë e lëndës përkatëse. Gjithashtu, nëpërmjet një formulari, institucioni bën vlerësim të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike kërkimore shkencore, *por GVJ konstaton se kërkimi shkencor dhe publikimet e stafit janë të pakta gjatë dy viteve të fundit. Ndërkohë për studentët nuk ka evidenca publikimi, përveç pjesëmarrjeve me prezantim në një konferencë studentore të organizuar në institucion.*<br>*GVJ rekomandon që institucioni dhe njësia bazë të ndërmarrë një plan aksion për nxitjen, mbështjen dhe publikimin e kërkimit shkencor në revista prestigjioze ndërkombëtare jo vetëm të stafit akademik, por edhe të studentëve të programit MSHAB.*<br><br>Aneks 2.33 Relacion për të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.<br>Aneks 2.49 Revista shkencore WISDOM, botimi fundit.<br>Aneks 2.50 Libri Manaxhim Total Cilësie, botuar nga pedagogët e KU WISDOM, Prof. Asoc. Dr.Naim Mëçalla dhe Dr. Enriko Ceko.<br>Formulari i vlerësimit të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike kërkimore shkencore. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë (NjKShMJ) vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të personelit akademik. NjKShMJ operon si njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Referuar |

| | |
|---|---|
| | Nenit 6, fq. 4, të rregullores së NjKShMJ, kjo njësi ka këto detyra:<br>1. Harton programin e masave për çdo vit akademik, ku pasqyron drejtimet kryesore të veprimtarisë, të miratuara nga Dekanati;<br>2. Studion dhe paraqet për miratim në Dekanat projekte kërkimore dhe mësimore, të orientuara nga standardet bashkëkohore;<br>3. Organizon konsulta për tema të rëndësishme që lidhen me politikat dhe projektet e FShESh veçanërisht për lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien;<br>4. Bashkërendon dhe koordinon veprimtarinë kërkimore të departamenteve, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik;<br>5. Promovon veprimtarinë kërkimore-shkencore të fakultetit, brenda dhe jashtë vendit;<br>6. Mbështet përfshirjen e personelit akademik për t`u bërë pjesë e projekteve institucionale apo ndëruniversitare.<br><br>Aneks 2.07 Rregullore e Njësisë së Kërkimit Shkencor dhe e Marrëdhënieve me Jashtë.<br>Aneks 2.33 Relacion për të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.<br>Formulari i vlerësimit të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike kërkimore shkencore. |
| **Kriteri 3.** Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe takimeve gjatë vizitës në institucion, ekspertët konkludojnë se *politika e promovimit të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor është e limitur brenda mundësive institucionale dhe projekteve të pakta të bashkëpunimit që mundësojnë vetëm pak emra nga stafi akademik të marrë pjesë. GVJ sugjeron që institucioni të shohë mundësitë e një politike më gjithëpërfshirëse duke përcaktuar kritere transparente për alokimin e fondeve të institucionit në fushën e kërkimit shkencor.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese. | Referuar dokumentave të konsultuara, ekspertët konstatojnë se *institucioni nuk disponon një mekanizëm për mbrojtjen e pronësisë intelektuale si në detyrat e kursit dhe punimet e tezës së diplomimit të studentëve, apo në botimet e revistës institucionale "Wisdom".* |
| **Kriteri 5.** Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor | Institucioni informon studentët për konferenca dhe aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit. KUW u ofron studentëve mundësi botimi të punimeve shkencore në revistën institucionale Wisdom, si dhe në konferencat shkencore të organizuara në institucion. |

| **Shkalla e përmbushjes së** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

| standardit | | X | | |
|---|---|---|---|---|

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

| **Standardi II.1**<br>**Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit është organizuar në module të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi (L. 80/2015 & VKM Nr. 41 datë 24.01.2018). Ky program është organizuar me lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisplinore dhe detyrime përmbyllëse, duke respektuar shpërndarjet në % për çdo kategori (Ref. Aneksit 3 05).<br>*GVJ sugjeron të rishikohet shpërndarja e lëndëve në kategoritë përkatëse. P.sh "SIM" i përket kategorisë D (lëndë plotësuese, njohuri kompjuterike), sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018).*<br><br>Aneks 3.05 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi". |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit "Master i shkencave" synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, synohet arsimimi profesional dhe shkencor i studentëve në fushën "Administrim Biznes".<br>Duke iu referuar Programit Mësimor (Aneks 3.05), duket se programi i studimit siguron një përgatitje të mjaftueshme që studentët të përshtaten në tregun e punës, në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.<br>Insitucioni i referohet përmbushjes së këtij kriteri bazuar edhe në një dokument (Aneks 3 02) të vënë në dispozicion, i cili përfshin disa informacione sipërfaqësore mbi tregun e punës, *por pa një metodologji të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave. Siç e kemi përmendur edhe më lart, rekomandohet të thellohet ky studim.*<br><br>Aneks 3.02 Studimi i tregut të punës para hapjes së programit "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi".<br>Aneks 3.05 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i |

| | |
|---|---|
| | Shkencave" në "Administrim Biznesi". |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.<br><br>**Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi i studimit të ciklit të dytë ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve me njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe praktike në fushën "Administrim Biznesi". Sipas IAL, programi është hartuar bazuar në studimin e kryer për nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit. *Por, siç u përmend edhe më lart, ky studim tregu mund të konsiderohet më tepër perceptim, duke qenë se i mungon metodologjia e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.*<br>Duke vlerësuar dosjen e këtij programi studimi, veçanërisht syllabuset e lëndëve (Aneks 3 12), dëshmojnë se programi ofron kryesisht literaturë bashkëkohore. Gjithashtu, bazuar në diskutimet e realizuara gjatë vizitës në IAL dhe komunikimit me pedagogët e lëndëve të këtij programi, GVJ konkludon se ky program studimi synon që të zhvillojë studentët me njohuri profesionale, të nevojshme për fushën "Administrim Biznesi". *Megjithatë, sugjerohet pasurimi dhe rinovimi i literaturës me botime të viteve të fundit. Kjo pasi vihet re se, në blerjet e titujve të reja për bibliotekën gjatë periudhës 2018-2019-2020, gjenden edhe botime të vjetra përpara viteve 2010.*<br><br>Aneks 2.41 Relacion për Biblotekën KU WISDOM, lista e blerjeve 2018-2019-2020.<br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II). |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Ky program studimi është hartuar duke marrë në konsideratë elementët e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe duke u shprehur në planin mësimor dhe programet mësimore të lëndëve të këtij programi studimi (Aneks 3 05).<br>Duke u bazuar në dosjen e këtij programi studimi dhe konstatimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, mund të konkludojmë se ky program studimi përmban elementët e nevojshëm që lejojnë krijimin e strukturës së tij. Kurrikula e programit të studimit hartohet nga departamenti dhe më pas miratohet nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.<br><br>Aneks 3.05 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi". |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Referuar Aneksit 3.05, programi i studimit MSh në "Administrim Biznesi" i ka lëndët të grupuara në lëndë të detyrueshme, karakterizuese dhe ndërdisplinore. Programi i studimit ka përcaktuar veprimtaritë formuese duke grupuar modulet në përputhje me kategoritë e përcaktuara në VKM Nr. 41 dt. 24/01/2018 *(Pika 2.5)* si edhe ngarkesën përkatëse në kredite për secilën kategori të veprimtarive formuese brenda këtij programi studimit duke respektuar peshën e përcaktuar në VKM Nr. 41 dt. |

| | |
|---|---|
| | 24/01/2018.<br>Shpërndarja e lëndëve sipas kategorive, të organizuara në semestra përgjatë dy viteve, është si vijon:<br>• Kategoria A: Lëndë bazë (përgatitja metodologjike dhe kultura e përgjithshme) – 10%;<br>• Kategoria B: Lëndë karakterizuese (formim specifik) – 50%;<br>• Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore (nëndisiplina, profile grup-lëndë me zgjedhje) – 15%;<br>• Kategoria D: Lëndë plotësuese (praktika profesionale) – 10%;<br>• Kategoria E: Detyrime përmbyllëse (përgatitja e tezës së diplomës) – 15%<br>*GVJ konstaton se, ky program i jep një peshë dhe pozicion të veçantë lëndës së "Drejtimit Financiar i Avancuar", "Ekonomiks Manaxherial" dhe "SIM", duke i konsideruar si Lëndë Bazë të Detyrueshme për këtë program studimi, ndërkohë që lëndë të tilla sipas mendimit të GVJ mund të konsideroheshin "Menaxhimi i Projekteve dhe Kontratave" apo "Menaxhim i Ndryshimit" aktualisht pozicionuar tek lëndët ndërdisiplinore, lëndë të cilat janë të një rëndësie të veçantë në ditët e sotme. Ndërsa, referuar VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, "SIM" i përket kategorisë D (Lëndë Plotësuese, njohuri kompjuterike).*<br>*Gjatë takimit të realizuar në Institucion me studentët e programit dhe sekretarinë mësimore, rezuloi se ata nuk kanë dijeni që programi ka edhe lëndë me zgjedhje. Praktikisht, kategoria C e lëndëve me zgjedhje nuk i ofrohet studentëve, pasi ato janë ofruar si lëndë të detyrueshme.*<br><br>Aneks 3.05 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi".<br>Aneks 3.10 Orari Mësimor.<br>Aneks 3.11 Propozimi për miratimin e lëndëve me zgjedhje Nr. Prot 39022 ,dt.01102019<br>Aneks 3.11 Vendimi i lëndëve me zgjedhje Nr. Prot 39023, dt.01102019. |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj | Bazuar në Rregulloren e programit të studimit MSh në "Administrim Biznesi" (Aneks 3.01) përcaktohen kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj. Përgatitja e diplomës kalon nëpër disa hapa, të përcaktuara në rregulloren (Aneks 3.14) dhe ka 18 kredite të cilat përbëjnë 15% të krediteve totale të programit. *Megjithatë, këto hapa duket se mbeten vetëm pjesë e rregullores së programit. Gjatë vizitës në institucion, ekspertët pyetën studentët dhe udhëheqësit e diplomave të tyre për metodat e kërkimit shkencor që ata po aplikonin në diplomat e tyre. Rezultoi se studentët kishin* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *njohuri të limituara mbi aktivitetet kërkimore. Gjithashtu, GVJ konstatoi se edhe kompjuterat në laboratorin e kolegjit nuk janë të pajisura me ndonjë software që do t'u vinte në ndihmë studentëve për analizimin statistikor të të dhënave të punimit të tyre të diplomës.*<br><br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimit të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Aneksi 3.14 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të temave të diplomave për studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi". | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | KUW përbëhet nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera të përcaktuara në statutin e tij sipas ligjit në fuqi *(L. 80/2015, Neni 22, pika 1)*. Gjithashtu, në përputhje me ligjin në fuqi *(L. 80/2015, Neni 22, pika 2)*, Fakuteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore është njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit nën akreditim.<br><br>Kjo njësi kryesore përbëhet nga 3 Departamente, si më poshtë, në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi.<br>1. Departamenti i Ekonomisë;<br>2. Departamenti i Psikologjisë;<br>3. NJKSH dhe MJ.<br><br>Departamenti i Ekonomisë është njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi dhe është i organizuar në përputhje me ligjin në fuqi *(L. 80/2015 - Neni 20, pika 2; Neni 22, pika 3; Neni 25, pika 1)*.<br>Në RVB citohet se Departamenti i Ekonomisë, për vitin akademik **19-20**, përbëhet nga **14** pedagogë si Personel akademik efektiv **(PAE)** dhe **2** pedagogë si Personel akademik me kontratë **(PAK)**, nga të cilët 9 janë me tituj e grada shkencore (1 Prof. Dr., 2 Prof. As., 6 Dr.,) dhe 7 me Master Shkencor.<br><br>*GVJ konstaton një mospërputhje të këtyre deklarimeve në RVB me ato të paraqitura në Tabelën 1 të Aneksit (2 16).* Referuar këtij Aneksi, Departamenti i Ekonomisë përbëhet nga **8** pedagogë si |

| | |
|---|---|
| | **Personel akademik efektiv (PAE)**, me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 2 Dr., 1 Dr. në proces dhe 3 Msc., dhe **2** pedagogë si **Personel akademik me kontratë (PAK)**, me kualifikimin: 1 Prof. As., dhe 1 Dr., në përputhje me kërkesat ligjore *(L. 80/2015 - Neni 25, pika 4; Neni 57, pika 1)*.<br><br>Për vitin akademik **18-19**, Departamenti i Ekonomisë, përbëhej nga **7** pedagogë si Personel akademik efektiv **(PAE)**, me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 3 Dr., dhe 2 Msc., dhe **3** pedagogë si Personel akademik me kontratë **(PAK)**, me kualifikimin: 1 Prof. As. dhe 2 Msc.<br><br>*GVJ rekomandon që kolegji të saktësojë deklarimet lidhur me stafin PAE dhe PAK.*<br><br>Aneksi 2.16 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, si njësia kryesore e këtij programi, bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor si edhe ofron programe studimore në nivele të ndryshme *(L. 80/2015, Neni 23, pika 1)* Ky fakultet përbëhet nga 3 njësi bazë, funksionimi i të cilave përcaktohet në statutin e KUW (Aneks 1.01). Njësia kryesore/bazë përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore *(L. 80/2015 - Neni 25, pika 4)*, për organizimin dhe strukturën akademike. Në njësinë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, janë minimumi 7 personel akademik efektiv, ku të paktën 3 prej tyre janë me tituj/grada. *Megjithatë, siç u përmend edhe më lart, vihet re nje mospërputhje midis shifrave të referuara në RVB dhe atyre në Aneksin 2.16.* Përgjegjësitë dhe kompetencat e Departamentit të Ekonomisë janë reflektuar në Rregulloren e Njësisë bazë *(Aneks 2.06, neni 9-10)* dhe Rregulloren e Programit të studimit *(Aneks 3.01, Kreu II)*.<br><br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti).<br>Aneks 2.16 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.<br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar. | Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, Departamenti i Ekonomisë, ka në përbërjen e tij 14 anëtarë si personel akademik efektiv dhe 2 personel akademik me kontratë. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi kërkohet të përmbushë detyrimet në përputhje me ligjin në fuqi *(L. 80/2015 - Neni 59, pika 6)*.<br><br>Siç përmendet edhe më lart, bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion, rezulton se njësia kryesore/bazë përmbush këtë kriter. |
| **Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për | |

| | |
|---|---|
| organizimin dhe strukturën akademike. | Aneks 2 16-17-18-19 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse. |
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj. | Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për realizimin e praktikave mësimore, projekteve studimore e kërkimore, angazhon personel akademik ndihmës të cilët në KUW janë pjesëtarët e Bibliotekës.<br>*Megjjithatë, nevojitet pajisja e laboratorëve kompjuterikë me programe që do ti mundësonin studentëve përpunimin e të dhënave në projektet e tyre kërkimore.*<br><br>Aneks 2.41 Relacion për Bibliotekën KU WISDOM. Lista e blerjeve 2018-2019-2020 |
| **Kriteri 6.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Departamenti i Ekonomisë, si Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, ka caktuar një profesor në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij, të reflektuara këto në Aneksin 2.25.<br><br>Aneks 2.25 Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit; Detyrat e koordinatorit të programit. |
| **Kriteri 7.** Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit | Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga GVJ, *përbëhet nga një relacion jo i detajuar i koordinatores së programit, i cili pasqyron mbarëvajtjen e programit në vija të përgjithshme, pa përfshirë tregues sasiorë për realizimin e objektivave të programit të studimit, si edhe propozime për rritjen e cilësisë së programit apo realizimin e objektivave në të ardhmen.* Gjithashtu, gjatë vizitave në institucion dhe bisedës me koordinatoren e programit, mësuam se *koordinatorja nuk kryen një analizë periodike të mbarëvajtjes së programit apo të dokumentojë çdo informacion që lidhet me programin e studimit, duke iu referuar këtyre detyrave si përgjegjësi e drejtuesit të departamentit. Ndërkohë, GVJ sugjeron ndërmarrjen e analizave të detajuara dhe të integruara të arritjeve dhe përmbushjeve të objektivave edhe në rang program studimi.*<br><br>Relacion i analizës vjetore nga koordinatorja e programit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, | Departamenti i Ekonomisë në KUW është njësia bazë mësimore- |

| | |
|---|---|
| përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | kërkimore për organizimin e programit të studimit MSh në "Administrim Biznesi". Ai disponon dokumentacionin e plotë për këtë program studimi ku përfshihen: Kurrikulat e programit të studimit; Plani mësimor si edhe Syllabuset e lëndëve. Kurrikula e këtij programi studimi është ndërtuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi *(VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018)*, *statutin e KUW* (Aneks 1.01), si edhe neneve *26-29 të Rregullores se Fakultetit*. Kurrikula përmban 17 lëndë të shpërndara në 4 semestra (referuar *neneve 18-19 të Rregullores se Fakultetit*). Secila lëndë mësimore vlerësohet me numrin e krediteve përkatëse 6 ECTS, kurse Praktika ka 12 ECTS dhe Punimi i Diplomës 18 ECTS. Për llogaritjen e krediteve është marrë parasysh ngarkesa e çdo moduli ku një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në *VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018 (Pika 2.1.b)*. Totali i krediteve plotëson numrin total të krediteve prej 120 ECTS. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. | |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | Plani mësimor (Aneks 3.04) përfshin elementët e mëposhtëm në përputhje me *VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018 (Pika 2.6):* emërtimi për secilin modul të këtij programi studimi për çdo kurs, të grupuara dhe të renditura sipas semestrave përkatës; numri i krediteve për çdo modul që është 6 ECTS; orët në total për secilin modul të cilat janë 60 orë dhe raporti i orëve - leksion/seminar është 2:2. Çdo modul ka detyrimet e tij (seminare, ushtrime, projekte kursi, detyra kursi, detyra kontrolli). Prakatika ka 240 orë mësimore dhe Punimi i Diplomës 60 orë. Vlerësimi i dijes së studentit është 40 % gjatë vitit. Ndërsa mënyra e kontrollit të dijeve për çdo modul në provimin final e ndeshim si provime me shkrim për të gjitha lëndët. Përjashtim nga mënyra e mësipërme e vlerësimit bëjnë "Praktika" dhe "Punimi i Diplomës".<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU Wisdom.<br>Aneks 2.05 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.<br>Aneks 3.04 Plani mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi". |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Statuti dhe Rregullorja e KUW (neni 65), Rregulloret e njësisë kryesore/bazë (Kreu VII, fq 22), Rregullorja e Transferimeve (Aneks 2.08), pasqyrojnë informacionet e nevojshme në lidhje me procedurat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në përputhje me ligjin në fuqi *(L. 80/2015, Neni 76, 89, VKM, 2.7 kuotat e pranimit)*. Ndërsa kriteret finale të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë të studime përcaktohen nga MASR për vitin akademik përkatës.<br>*Megjithatë, GVJ konstatoi gjatë takimit me stafin mësimdhënës, sekretarinë mësimore dhe studentët e programit, se institucioni* |

| | |
|---|---|
| | *nuk aplikon kritere specifike dhe të veçanta në përzgjedhjen e kandidatëve dhe sidomos të atyre që vijnë nga fusha të tjera studimi, pasi ata hasin vështirësi në lëndët e avancuara të programit si p.sh. Drejtimi Financiar i Avancuar.*<br>*GVJ rekomandon vendosjen dhe publikimin e të gjitha informacioneve të nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në funksion të procedurave të përcaktuara në rregulloret e tij.*<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU Wisdom.<br>Aneks 1.02 Rregullore e KU Wisdom.<br>Aneks 2.05 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.<br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti).<br>Aneks 2.08 Rregullore për Transferimin në programet e studimit "Bachelor" dhe "Master i Shkencave". |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Për Programin MSH në "Administrim Biznes", programi i lëndës që përdoret për hartimin e syllabuse-ve është modeli i përcaktuar në *VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca nr.2).* Syllabuset e lëndëve të këtij program studimi janë të detajuara dhe respektojnë elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve *VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 (Shtojca nr.2). Vlen të përmendet rekomandimi për përditësimin e literaturës së 5 viteve të fundit në shqip dhe anglisht.*<br><br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II). |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht | Kurrikula e Programit MSH në "Administrim Biznes" po zbatohet për herë të parë, pasi ky program ka filluar në vitin akademik 2018-2019, me brezin e parë të studentëve. *Ka nje vendim senati (Aneks 2.37) për ndryshimin e planit mësimor në përputhje me VKM Nr. 41, por është i paqartë ndryshimi.* Kjo paqartësi është edhe nga spjegimi i dhënë në RVB, ku përmendet përpjekja për përmirësim të vazhdueshëm, por nuk sqarohen ndryshimet e bëra. Gjatë vizitës në IAL, mësuam se institucioni ka bërë përqasjen e syllabuseve dhe shpërndarjen e lëndëve në kategoritë A-E, në përputhje me VKM Nr. 41.<br><br>Aneksi 2.37 VKM Nr.41 Vendimi i senatit për ndryshimin e planeve mësimore Nr. 8. Prot., datë 17.12.2018. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.4** |
|---|
| **Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat** |

| formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit "Master i Shkencave"/"Master i Arteve" është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Programi i studimit përmban një ngarkesë mësimore të hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, duke i shtrirë studimet në dy vite akademike, të ndarë në 4 semestra dhe të organizuar mbi bazën e lëndëve në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi *(VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, Pika 2.1.d)*. Ngarkesa mësimore vjetore në auditor në lidhje me leksione, seminare, ushtrime, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe praktika të zhvilluara në auditor, është 600 orë mësimore 50-minutëshe, e përkthyer në 60 kredite ECTS në vit.<br><br>Aneks 3.04 Plani mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi".<br>Aneks 3.05 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi".<br>Aneks 3.06 Struktura e programit "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.<br><br>**Kriteri 3.** Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive formuese të Programit MSH "Administrim Biznes" mundësojnë thellimin dhe aftësimin e studentëve në fushën e menaxhimit të organizatave me kapital privat dhe publik duke i dhënë atyre aftësi në krijimin e sipërmarrjeve dhe menaxhimin e tyre me qëllim rritjen e jetëgjatësisë dhe të ardhurave të qëndrueshme.<br>Në takimet me pedagogët e angazhuar në këtë Program studimi, u shprehën se orët e mësimit në auditor (leksione, seminare, ushtrime apo praktika në laboratorë) zhvillohen në formë interaktive ndërmjet pedagogut dhe studentit, ku pedagogët paraqesin shembuj të ndryshëm për të mbështetur pjesën teorike dhe raste studimi të ndryshme për të stimuluar mendimit krijues dhe kritik të studentit. Këto u konfirmuan edhe nga takimi me studentët gjatë vizitës në KUW, por jo për të gjitha lëndët.<br>*Nga takimi i realizuar me pedagogët dhe studentët e programit, pyetëm dhe morëm përgjigje prej tyre lidhur me angazhimin që kanë studentët në konferenca studentore, por kjo konsistonte vetëm në një prezantim dhe jo një punim shkencor.*<br><br>Aneks 3.04 Plani mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi".<br>Aneks 3.05 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi".<br>Aneks 3.06 Struktura e programit "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti | Struktura, organizimi dhe programi studimit duke përfshirë natyrën e moduleve të ofruara, ngarkesën e tyre në ECTS, raportin |

| | |
|---|---|
| teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | e aspekteve teorike dhe aplikimeve të mundshme praktike, si edhe kërkimin shkencor, është në përputhje me profilin e këtij programi master shkencor. |
| **Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike të informacionit që jep një modul dhe aplikimeve të mundshme praktike. Gjithashtu, për specifikën që paraqet, tenton të mbulojë nevojat në tregun e organizatave me kapital privat dhe publik në Shqipëri dhe vendet e rajonit.<br><br>Ngarkesa në orë mësimore prej 3000 orësh dhe me kredite prej 120 ECTS në dy vite (Anekset 3.01 dhe 3.05), tregon se ky program i përmbahet përcaktimeve ligjore për këtë cikël studimi dhe e përafron atë me programe të tjera të ngjashme ndërkombëtare.<br><br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.05 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi".<br>Aneks 3.06 Struktura e programit "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 6.** Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi (Aneks 3.12) përmbajnë formatin dhe elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve të *VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 (Shtojca nr.2)*.<br><br>Gjatë takimeve me anëtarët e GVB-së dhe pedagogët që japin mësim në këtë program studimi, ashtu si edhe shprehet në RVB, na u referua se syllabuset përditësohen para çdo semestri.<br><br>Referuar RVB-së për këtë kriter, literatura e detyruar dhe ndihmëse është e 5 viteve të fundit. *Por, GVJ, konstaton nga kontrolli i syllabuseve në Aneksin 3.12, se ka module që kanë nevojë të përditësojnë literaturën bazë dhe rekomanduese, duke qenë se shkon përtej harkut kohor të 5 viteve të fundit (p.sh Literatura e detyruar për "Marrje vendimi dhe zgjidhje problemi" në syllabusin 2019-2020, është e vitit 2010).*<br><br>*Gjithashtu, pjesa më e madhe e titullarëve të lëndëve (me përjashtim të lëndëve: "Menaxhim Operaciones" dhe "SIM"), nuk i përkasin kategorisë "Profesor", sikurse parashikuar në Nenin 59, pika 3, të Ligjit 80/2015.*<br><br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II).<br>Syllabus Marrje Vendimi dhe Zgjidhje Problemi 2019-2020. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit | Programi MSH në "Administrim Biznesi" ka si fokus marrjen e njohurive bazë mbi metodat dhe parimet për formimin e shprehive të veçanta në këtë fushë. Studentët fitojnë aftësi dhe kompetenca |

| | |
|---|---|
| të ciklit të dytë. | të nevojshme lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e sipërmarrjeve, funksionet e marketingut, financës, marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e problemeve. *Më tepër vëmendje sugjerohet ti kushtohet dijeve dhe kompetencave në fushën e metodave kërkimore, njohja edhe me programet kompjuterike si SPSS, SAS, etj.*<br><br>Aneks 3.06 Struktura e programit "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 8.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.<br><br>**Kriteri 9.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Zhvillimet e reja në tregje kanë bërë të nevojshme përshtatjen e kurrikulave mësimore me aftësitë që kërkon tregu i punës. Për rrjedhojë në kryerjen e ndryshimeve në kurrikula apo në përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin në fjalë. Drejtuesit e njësive dhe pedagogët shprehën se kanë kryer studim tregu i cili ka patur si qëllim të identifikojë se cilat janë njohuritë, aftësitë apo kompetencat që kërkojnë bizneset nga ekspertët e rinj apo nga studentët e diplomuar, si punonjës potencial në tregun e punës. *Megjithatë, sikurse thënë edhe më herët, ky studim nuk ka një metodologji e cila të mundësojë që rezultatet e studimit të reflektohen në hartimin e kurrikulës bashkëkohore apo në ndryshimet e mundshme në syllabuset e lëndëve.*<br><br>Aneks 3.02 Studimi i tregut të punës para hapjes së programit "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi". |
| **Kriteri 10.** Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve | Programi MSH "Administrim Biznesi", si program studimi i ciklit të dytë, synon të kujdeset që të pajisë studentët me njohuritë bazë të nevojshme profesionale dhe shkencore për të ndjekur trajnime të tjera të thelluara profesionale apo dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve. Edhe pse programi përfshin në kurrikulën e tij organizimin e lëndëve të tilla si "Metodat e Kërkimit Shkencor", *takimi me studentët dëshmoi se ata kanë njohuri dhe aftësi shumë të limituara për kërkime e analiza shkencore, gjë e cila cënon përgatitjen e tyre për të avancuar në studime shkencore më të thelluara si doktoratura.*<br>*Rekomandohet thellimi i studentëve në fushën e metodave kërkimore, njohja e tyre edhe me programet kompjuterike si SPSS, SAS, etj.*<br><br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.05 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi". |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| standardit | | | X | |
|---|---|---|---|---|

| Standardi II.5<br>**Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve".** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. | Referuar të dhënave tabelare të Aneksit 2.17, KUW përmbush kërkesat ligjore në fuqi lidhur me personelin akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. | Sipas listës së personelit akademik të programit të studimit, rezulton se të angazhuar në këtë program studimi, për vitin akademik **2019-2020**, janë **8** personel akademik nga të cilët **6 PAE** dhe **2 PAK.** Personeli akademik efektiv **(PAE)** paraqitet me kualifikimin: **1 Prof. As., dhe 5 Dr.**, ndërsa Personeli akademik me kontratë **(PAK)** paraqitet me kualifikimin: **1 Prof. As., dhe 1 Dr.**<br><br>Për vitin akademik **2018-2019** *(sipas listës emërore të stafit për programin të përcjellë pas vizitës në IAL),* në këtë program studimi janë angazhuar **8** personel akademik nga të cilët **7 PAE** dhe **1 PAK.** Personeli akademik efektiv **(PAE)** paraqitet me kualifikimin: **1 Prof. As., dhe 6 Dr.**, ndërsa Personeli akademik me kontratë **(PAK)** paraqitet me kualifikimin **Prof. As.**<br><br>Sipas të dhënave për vitin akademik aktual 2019-2020, të cilat gjenden në Aneksin 2.17, si edhe vitin 2018-2019 (*lista emërore e stafit për programin të përcjellë pas vizitës në IAL),* lista e lektorëve të përfshirë në këtë program studimi, personeli akademik PAE dhe PAK të angazhuar në këtë program studimi, kanë të gjithë grada shkencore.<br><br>Sipas Evidencës ne Aneksin (2.17), Për vitin akademik 2019-2020, 180 orë ose **15%** *(në RVB 12.5%)* të totalit janë kryer respektivisht nga **PAK** dhe të ftuar dhe 1020 orë ose **85%** *(në RVB 87.5%)* të totalit janë kryer respektivisht nga **PAE**, të gjithë me grada shkencore. Ndërsa në vitin paraardhës 2018-2019, (sipas *listës emërore të stafit për programin të përcjellë pas vizitës në IAL)* vetëm 60 orë ose **5%** të totalit janë kryer respektivisht nga **PAK** dhe **95%** të totalit janë kryer respektivisht nga **PAE**, të gjithë me grada shkencore. |

| | |
|---|---|
| | Në përfundim, GVJ evidenton se, Personeli Akademik që angazhohet në mësimdhënie në Programin e studimit për vitin akademik 2019-2020, kanë një gradë më lartë se sa cikli i studimit ku japin mësim, sipas *Ligjit 80/2015 - Neni 59, pika 6*. Gjithashtu, profili i tyre akademik dhe interesat kërkimore, përputhen me profilin e lëndëve për të cilat angazhohen në program.<br>*Por, sikurse përmendur edhe më lart, pjesa më e madhe e titullarëve të lëndëve (me përjashtim të lëndëve: "Menaxhim Operaciones" dhe "SIM"), nuk i përkasin kategorisë "Profesor", sikurse parashikuar në Nenin 59, pika 3, të Ligjit 80/2015.*<br><br>Aneks 2.16 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.<br>Aneks 2 16-17-18-19 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.<br>Lista emërore e stafit PAE dhe PAK për programin. |
| **Kriteri 3.** Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | Për fushën akademike-kërkimore të anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, përgjithësisht, kanë bërë përpjekje të jenë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku japin mësim. Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik të këtij programi, del në pah angazhimi i personelit për të zhvilluar specializime në fusha studimi që mund të përkojnë me fushat që ata mbulojnë në kurrikulën e programit të studimit.<br><br>Aneks 2 13 CV e stafit akademik të programit të studimit. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Duke iu referuar kurrikulës së programit rezulton se studentët gjatë semestrit të 2-të të vitit të 2-të, zhvillojnë praktikën profesionale dhe paralelisht përgatisin temën e diplomës. Natyra e këtij programi studimi kërkon kryerjen e praktikës profesionale pranë organizatave me kapital privat dhe publik të ndryshme, të madhësive dhe industrive të ndryshme.<br><br>Sivjet do të ishte viti i parë i kryerjes së praktikës, gjë e cila u pengua për shkak të situatës globale të pandemisë.<br><br>Edhe punimi i diplomës kryhet për herë të parë në këtë program studimi. Si rregull (Aneksi 3.01), studenti supervizohet nga pedagogu udhëheqës gjatë periudhës së zhvillimit të punimit të diplomës. Gjithashtu, nga komunikimi me studentët gjatë vizitës në institucion, rezultoi se ata janë në komunikim të vazhdueshëm me pedagogët e tyre përmes platformës elektronike edhe komunikimit ballë për ballë me pedagogun udhëheqës, pedagogun e lëndës, etj, për çdo problematikë që mund të hasin gjatë procesit mësimor në këtë program.<br><br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i |

| | |
|---|---|
| | Shkencave në Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit | Studentët e këtij programi studimi nuk kanë orë specifike që të kenë nevojën e personelit ndihmësmësimor-shkencor. Megjithatë, stafi mbështetës i KUW ishte gjithmonë disponibël për çdo nevojë të tyre nëse do të nevojitej.<br><br>Aneks 3.06 Struktura e programit "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Sipas RVB-së, strukturat përgjegjëse të studimit kryejnë përmirësimin e programit të studimit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut duke realizuar studimin e tregut në fushën "Administrim Biznesi" si edhe bashkëpunojnë me aktorët e tregut. Gjithashtu, sipas diskutimeve gjatë vizitave në KUW, nga drejtuesit e njësive na u bë me dije se ata bashkëpunojnë me aktorë nga tregu i punës dhe konsiderojnë propozimet e tyre. *Megjithatë, institucioni nuk disponon ndonjë evidencë për implementimin e këtyre propozimeve, përveç një studimi tregu, i cili nuk pasqyron të dhëna konkrete dhe nuk ka një metodologji të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.*<br><br>Aneks 3.02 Studimi i tregut të punës para hapjes së programit "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi". |
| **Kriteri 2.** Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. | KUW shprehet në RVB dhe dokumenta të tjera si rregulloret e institucionit dhe programit (referuar gjithashtu procesverbalit të mbledhjeve departamentale në Aneksin 2.57), apo përmes pyetësorëve të studentëve, se i përfshin ata në përmirësimin e programit të studimit. *Megjithatë, GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se studentët nuk janë të përfshirë në diskutime apo angazhuar me pjesë konkrete në përgatitjen e materialit të RVB-së si dhe gjithashtu rezultatet e pyetësorëve nuk janë reflektuar në masa konkrete në funksion të përmirësimit të programit të studimit.*<br><br>Aneks 2.57 Proces verbal mbledhjesh departamentit për vendime të MSHAB. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në | Në këtë program studimi ende nuk është diplomuar brezi i parë i |

| | |
|---|---|
| mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit. | studentëve. |
| **Kriteri 4.** Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi | KUW ka diskutuar në mbledhjet e saj departamentale (Aneks 2.57) hapjen e programeve të reja të studimit në nivel master, sipas kërkesave të tregut. Por kjo ka mbetur vetëm në nivel diskutimi.<br><br>Aneks 2.57 Proces verbal mbledhjesh departamentit për vendime të MSHAB. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | GVJ vlerëson, nga shqyrtimi i dokumentave strategjikë të KUW, *(Statuti, Plani Strategjik, Rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit)* dhe nga vizita në institucion, se programi i studimit MSH "Administrim Biznesi" është në përputhje e në zbatim të planit strategjik dhe objektivave madhorë të institucionit, në kuadër të strategjisë afatgjatë të zhvillimit të KUW, të tilla si: procesin e mësimdhënies/mësimnxënies, kërkimin shkencor, bashkëpunimin kombëtar e ndërkombëtar, studentët, etj.<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU Wisdom.<br>Aneks 1.02 Rregullore e KU Wisdom., kreu XII.<br>Aneks 1.03 Plani strategjik i zhvillimit i KU Wisdom, kreu VI & VII.<br>Aneks 2.04 Plani strategjik për zhvillimin e departamentit (në nivel akademik, financiar, burimesh njerëzore etj).<br>Aneks 2.05 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.<br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti). |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | Gjatë takimit me stafin akademik, por edhe nga shqyrtimi i dosjeve të tyre, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, ka disa instrumenta nxitës të tillë si fondi i venë në dispozicion nga IAL për kërkimin shkencor, mundësi për publikimin e artikujve dhe materialeve shkencore në revistën shkencore të KUW, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit (neni 6, fq. 4, të rregullores së NjKShMJ). *Megjithatë, puna kërkimore dhe botimet që lidhen me fushën kryesore të studimit të këtij programi, janë ende të limituara.*<br><br>Aneks 2.07 Rregullore e Njësisë së Kërkimit Shkencor dhe e Marrëdhënieve me |

| | |
|---|---|
| | Jashtë.<br>Aneks 2.33 Relacion për dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Institucioni përfshin studentë të programit në prezantime konferencash studentore dhe projektin kërkimor Erasmus+ "Cultural Studies in Business", *por këto nuk kanë përfunduar në një punim shkencor dhe botim.*<br><br>Aneks 2.48 Axhenda e Konferencës Studentore ndëruniversitare, 24 Prill 2019. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare. | KUW ka vendosur marrëdhënie të ndryshme bashkëpunimi në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor të programit MSHAB. Këto marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe aktorë të biznesit janë në mbështetje të realizimit të veprimtarive të përbashkëta kërkimore shkencore.<br><br>*GVJ rekomandon përfshirjen e institucionit në më tepër projekte rajonale dhe kombëtare, për të ofruar më tepër mundësi integrimi të studentëve në projekte kërkimore shkencore.*<br><br>Aneks 2.22 Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale.<br>Aneks 2.44 Marrëveshje bashkëpunimi me ERASMUS.<br>Aneks 2.47 Axhenda e 4-th transnational meeting 17-18.01.2020 Cultural Studies in Business project.<br>Aneks 2.51 Axhenda e workshopit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M Nate, programi i workshopit. |
| **Kriteri 5.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme | KUW ka marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të projekteve ERASMUS, (Universiteti La Sapienza në Itali) nëpërmjet të cilit mbështet financiarisht stafin akademik për aktivitete kërkimore shkencore. Gjithashtu, KUW mbështet publikimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të stafit akademik efektiv dhe me kontratë nëpërmjet revistës Wisdom me ISSN: 2410-8472. Institucioni ka financuar edhe publikimin e librit "Manaxhimi Total i Cilësisë", i cili përdoret si literaturë e lëndës përkatëse.<br>*GVJ rekomandon që këto bashkëpunime të rriten në numër dhe institucioni të hartojë dhe shpallë kritere për aplikimin e një politike financimi në mënyrë të barabartë të stafit akademik, por edhe të studentëve të programit MSHAB.*<br><br>Aneks 2.33 Relacion për dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.<br>Aneksi 2.44 Marrëveshje bashkëpunimi me ERASMUS.<br>Aneks 2.49 Revista shkencore WISDOM, botimi fundit.<br>Aneks 2.50 Libri Manaxhim Total Cilësie, botuar nga pedagogët e KU WISDOM, Prof.Asoc.Dr.Naim Mëçalla dhe Dr.Enriko Ceko.<br>Formulari i vlerësimit të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike kërkimore shkencore. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.8**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | KUW ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit në kuadër të kërkimit shkencor. *Megjithatë, gjatë vizitave në institucion, rezultoi se programi i studimit nën vlerësim, ka përfituar pak prej këtyre marrëveshjeve. GVJ rekomandon që këto bashkëpunime të rriten në numër.*<br><br>Aneks 2.33 Relacion për dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.<br>Aneks 2.44 Marrëveshje bashkëpunimi me ERASMUS. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.<br><br>**Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave | Institucioni, nëpërmjet një formulari, bën vlerësim të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike kërkimore shkencore. KUW ka ngritur Njësinë e Kërkimit Shkencor dhe e Marrëdhënieve me Jashtë (NjKShMJ) e cila në bashkëpunim me departamentet përkatëse është përgjegjëse dhe angazhon personelin akademik lidhur me kërkesat për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor. Ka pasur përpjekje të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi për projekte dhe botime të karakterit kërkimor-shkencor, si psh. Botimi i librit te Menaxhmit të Cilësisë, megjithatë *GVJ konstaton se kërkimi shkencor dhe publikimet e stafit te ketij programi, janë të pakta gjatë dy viteve të fundit. Ndërkohë, për studentët, nuk ka evidenca publikimi, përveç pjesëmarrjeve me prezantim në një konferencë studentore të organizuar në institucion.*<br>Gjithashtu, *institucioni nuk disponon një procedurë transparente për alokimin e fondeve në kuadër të kërkimit shkencor.*<br>Sikurse përmendur edhe më sipër, *GVJ, rekomandon që këto bashkëpunime të rriten në numër dhe institucioni të hartojë dhe shpallë kritere për aplikimin e një politike financimi në mënyrë të barabartë të stafit akademik, por edhe të studentëve të programit MSHAB.*<br><br>Aneks 2.07 Rregullore e Njësisë së Kërkimit Shkencor dhe e Marrëdhënieve me Jashtë.<br>Aneks 2.33 Relacion për dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.<br>Aneks 2.44 Marrëveshje bashkëpunimi me ERASMUS.<br>Aneks 2.49 Revista shkencore WISDOM, botimi fundit. |

| | |
|---|---|
| | Aneks 2.50 Libri Manaxhim Total Cilësie, botuar nga pedagogët e KU WISDOM, Prof.Asoc.Dr.Naim Mëçalla dhe Dr.Enriko Ceko.<br>Formulari i vlerësimit të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike kërkimore shkencore. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | X | | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve. | Pedagogët në KUW njihen me Ligjin aktet nënligjore dhe udhëzimet e MASR për IAL, me Statutin e institucionit, Rregulloren e NJSBC si edhe Fakulteteve, departamenteve dhe programeve të studimit, të cilat parashikojnë zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Stafi akademik është pjesë e marrëveshjeve të mobilitetit (projekti ERASMUS+) dhe workshopeve (KUW në bashkëpunim me pedagogun e huaj Ronald M. Nate, IRISOFT), me synim rritjen profesionale të tyre edhe në kuadër të implementimit të metodave të reja të mësimdhënies nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me institucionet e huaja (edhe pse këtu janë përfshirë një numër i vogël nga stafi i fakultetit ekonomik).<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU Wisdom, neni 27.<br>Aneks 1.02 Rregullore e KU Wisdom, neni 20.<br>Aneks 1.04 Rregullore e njësisë së zhvillimit të brendshëm të cilësisë.<br>Aneks 2.33 Relacion për dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.<br>Aneks 2.38 Vendim i departamentit për materialet didaktike.<br>Aneks 2.44 Marrëveshje bashkëpunimi me ERASMUS.<br>Aneks 2.51 Axhenda e workshopit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M Nate, programi i workshopit.<br>Aneks 2.52 Relacion trajnimi i Irisoft Education me temë "Formimi i stafit akademik me risitë kurrikulare"; Programi trajnimit. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të | Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit |

| | |
|---|---|
| monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | akademik bëhet në mënyrë periodike nga departamenti i Ekonomisë dhe në rang Fakulteti. Si instrument përdoret pyetësori me studentët i cili realizohet para provimeve, rezultatet e anketimit te përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore, në bashkërendim me NJSBC. Përgjatë vitit akademik, realizohen kontrolle periodike nga NJSBC. *Edhe pse sipas RVB dhe aneksit 2.31 thuhet se NJSBC harton një kalendar kontrollesh, GVJ konstaton që ky kalendar është hartuar për programin Bachelor dhe jo MSHAB. Për më tepër (ashtu siç specifikohet edhe në vijim në fushën V) GVJ nuk evidenton raporte vlerësuese për përmirësime të problematikave të mëparshme, qoftë të programit apo institucionit. Si rrjedhim, rekomandohet që institucioni të hartojë raporte në bazë programi të cilat të bëhen publike.*<br>Aneks 2.29 Modele të pyetësorëve të studentëve dhe pedagogëve.<br>Aneks 2.31 Kalendar i NJSBC për përformancën akademike. Raport të përformancës akademike.<br>Aneks 2.32 Relacion semestral për pyetësorin e studentëve. |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet anketave dhe pyetësorëve, kjo e parashikuar në *nenin 15 të rregullores së NJSBC*. Studentët kanë gjithashtu të drejtën e paraqitjes së mendimit të tyre lidhur me përmirësimin e procesit mësimor *(parashikuar në Rregulloren e Fakulteti, neni 56, pika 10)*<br>*Sugjerohet që keto anketa të bëhen pjesë e analizës periodike të mbarëvajtjes së programit të studimit dhe përfundimet t'ju bëhen të ditura dhe studentëve.*<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU Wisdom, neni 27.<br>Aneks 1.02 Rregullore e KU Wisdom, neni 20.<br>Aneks 1.04 Rregullore e njësisë së zhvillimit të brendshëm të cilësisë.<br>Aneks 2.05 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, neni 56.<br>Aneks 2.29 Modele të pyetësorëve të studentëve dhe pedagogëve.<br>Aneks 2.32 Relacion semestral për pyetësorin e studentëve. |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Strukturat përgjegjëse (njësia bazë dhe kryesore) bëjnë publike rezultatet në analizën vjetore të njësisë, të cilat përcillen nga NJSBC në rektorat. Gjithashtu, rezultatet e vlerësimit publikohen në webfaqen e KUW.<br>*Megjithatë, GVJ, gjatë shqyrtimit të dokumentave në dispozicion, nuk gjeti reflektime lidhur me problematikat e gjetura.*<br><br>Aneks 1.04 Rregullore e njësisë së zhvillimit të brendshëm të cilësisë.<br>Aneks 2.21 Të dhëna tabelore për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë. |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe | Nga takimet ne institucion, konstatuam se Fakulteti i Shkencave |

| | |
|---|---|
| rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies | Ekonomike dhe Shoqërore, përdor mënyra për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, këto të referuara në Aneksin 2.30, *i cili në fakt relaton mbledhjen e kryer nga departamenti me studentët bachelor dhe jo master.*<br>Pyetësori i studentëve synon të përdoret si mjet për të evidentuar dhe vlerësuar shembuj të mirë dhe efikas në procesin e mesimdhënies dhe mësimnxënies (Anekset 2.31 dhe 2.32), *por GVJ nuk gjen reflektim të rezultateve të këtyre pyetësorëve në masa konkrete për përmirësimin e programit.*<br>KUW përpiqet të promovojë shembuj të praktikave të mira në mësimdhënie nëpërmjet leksioneve të hapura (Aneks 2.53 dhe 2.51).<br><br>Aneks 2.30 Raporte të takimeve periodike me studentë për mbarëvatjen mësimore.<br>Aneks 2.31 Kalendar i NJSBC për përformancën akademike. Raport të përformancës akademike.<br>Aneks 2.32 Relacion semestral për pyetësorin e studentëve.<br>Aneks 2.51 Axhenda e workshopit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M Nate, Programi i workshopit.<br>Aneks 2.53 Program vjetor i veprimtarisë Kerkimore Shkencore; Leksion i Hapur ne departament i pedagogëve të programit Master i Shkencave në Administrim Biznesi Dr. E.C, Dr. L.Sh. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të njohurive në KUW përfshijnë: leksione dhe seminare, leksione të hapura brenda dhe jashtë institucionit (aneksi 2.51 dhe 2.53), detyra/projekte kursi, raste studimore, vizita dhe trajnime studimore (aneksi 2.54), të pasqyruara në syllabuset lëndore; praktikë profesionale, tema diplome.<br><br>Aneks 2.51 Axhenda e workshopit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M Nate, Programi i workshopit.<br>Aneks 2.53 Program vjetor i veprimtarisë Kerkimore Shkencore; Leksion i Hapur ne departament i pedagogëve të programit Master i Shkencave në Administrim Biznesi Dr. E.C, Dr. L.Sh.<br>Aneks 2.54 Relacion trajnimi i studentëve te programit Master i Shkencave në "Split University" në Kroaci, Axhenda e trajnimit.<br>Aneks 2.55 Relacion për "Forumin e Hapur" në bashkëpunim me Bashkinë |

| | |
|---|---|
| | Tiranë dhe Organizatën "Trajnim, Edukim dhe Demokraci" (TED), me temë "Të rinjtë në vendimarrje".<br>Aneks 3.04 Plani mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi".<br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II). |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. | Syllabuset përkatëse të lëndëve e moduleve (Aneksi 3.12) specifikojnë, përveç literaturës bazë dhe të sugjeruar, edhe format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve. Modulet mësimore janë të organizuara në leksione dhe seminare të integruara, ushtrimet, praktikat profesionale, vizita studimore pranë bizneseve, detyrat e kursit/projektet e kursit, etj. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit. Gjithashtu në KUW modulet shoqërohen me raste studimore në klasë apo vizita studimi pranë bizneseve për t'ju përgjigjur diversitetit dhe nevojave të studentëve.<br><br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesorebazë (Departamenti), neni 9<br>Aneks 2.28 Model Relacioni Semestral i pedagogut.<br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II). |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | Stafi akademik mbështetet nga institucioni për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave didaktike përmes trajnimeve (psh. IRISOFT), shkëmbimit të eksperiencave në kuadër të një projekti ERASMUS që ka KUW, apo aktivitete dhe leksioneve të hapura që organizon institucioni, duke mundësuar kështu realizimin e objektivave formuese dhe rezultate të kënaqshme të të nxënit.<br>*GJV rekomandon shtimin e numrit të marrëveshjeve edhe në kuadër të mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve, pasi ato ndihmojnë procesin e mësimdhënies e mësimnxënies në përputhje me objektivat formuese dhe kërkesat aktuale të punëdhënësve.*<br><br>Aneks 1.01 Statusi i KU Wisdom., neni 27.<br>Aneks 1.02 Rregullore e KU Wisdom, neni 20.<br>Aneks 1.04 Rregullore e njësisë së zhvillimit të brendshëm të cilësisë.<br>Aneks 2.33 Relacion për dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.<br>Aneks 2.38 Vendim i departamentit për materialet didaktike.<br>Aneks 2.44 Marrëveshje bashkëpunimi me ERASMUS.<br>Aneks 2.52 Relacion trajnimi i Irisoft Education me temë "Formimi i stafit akademik me risitë kurrikulare"; Programi trajnimit. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi plotëson kriteret ligjore të kualifikimit. Profili i profesorëve përputhet me lëndët qe ata ofrojnë në program, duke i bërë ata kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve.<br>Për lëndët dhe modulet ekzistojnë tekste, leksione dhe materiale të tjera që u vihen në dispozicion studentëve, të mundësuara edhe |

| | |
|---|---|
| | nga libraria e universitetit. Siç kemi përmendur edhe më lart, në KUW përdoren metoda të ndryshme të mësimdhënies duke integruar edhe raste studimore, leksione të hapura apo vizita studimore në terren, sipas tematikave dhe profilit.<br><br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II).<br>Aneks 2.33 Relacion për dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | GVJ konkludon se Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve, duke u bazuar në RVB, rregulloren e NJSBC si edhe konstatimeve gjatë takimeve në institucion. NJSBC ndërmerr vlerësime nëpërmjet pyetësorit të studentëve dhe stafit akademik, me qellim që të identifikojnë problemet që duhen përmirësuar dhe vlerësojnë arritjet. Gjithashtu, pyetëm dhe morëm përgjigje gjatë takimeve në IAL, se nuk ka patur raste vërejtjesh për përmirësim apo ndryshime për format e metodat e mësimdhënies. *Megjithatë, gjatë takimeve me stafin akademik, kishte vërejtje për mënyrën e demonstrimit dhe përkthimit të rezultateve të pyetësorëve të studentëve.*<br>*GVJ sugjeron rishikimin e formatit të pyetësorëve dhe integrimin e matësve sasiorë në të, për të lehtësuar punën e analizimit dhe rritur transparencën e interpretimit të rezultateve.*<br><br>Aneks 1.04 Rregullore e njësisë së zhvillimit të brendshëm të cilësisë.<br>Aneks 2.29 Modele të pyetësorëve të studentëve dhe pedagogëve.<br>Aneks 2.32 Relacion semestral për pyetësorin e studentëve. |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | Mënyrat e angazhimit dhe vlerësimit të studentëve janë paraqitur në çdo syllabus (Aneksi 3.12). Orët e mësimit janë interaktive, ku studentët bashkëveprojnë me pedagogët dhe njëri-tjetrin.<br>Nga vizita ne institucion mësuam se personeli akademik përpiqet që të angazhojë studentët me diskutime brenda fushës së lëndës apo realizojnë vizita studimore, për ta bërë më tërheqëse orën e mësimit.<br><br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II). |
| **Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre | Format dhe metodat e mësimdhënies në KUW, inkurajimi i diskutimeve dhe debateve gjatë orës së mësimit, veçanërisht inkurajimi i tyre për të marrë pjesë në konferencën studentore *(Aneksi 2.48 Axhenda e Konferencës Studentore ndëruniversitare, prill 2019)* ndihmon studentët në shprehjen e mendimit të tyre dhe krijimit të një autonomie të menduari dhe të gjykuari. Fryma e KUW ku studenti vendoset në qendër të aktiviteteve mësimore, u jep mundësi pedagogëve që ti lejojnë studentët të diskutojnë më shumë dhe të shprehin hapur opinionet e tyre, duke vendosur edhe |

| | |
|---|---|
| | një marrëdhënie të ndërsjelltë respekti midis tyre, gjë e cila u vu re edhe gjatë vizitave në institucion dhe intervista me studentët.<br><br>*Megjithatë, GVJ sugjeron që institucioni të rrisë përpjekjet për të përfshirë më shumë studentët në aktivitete shkencore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | Studentët e programit MSh në "Administrim Biznesi" zhvillojnë mësimin në mjedise cilësore brenda kampusit të KUW të përbërë nga dy godina, i cili ofron mjedise të mjaftueshme për numrin e studentëve, të grupeve mësimore dhe në përputhje me specifikën që kanë lëndët dhe modulet e këtij programi studimi. Ajo është e pajisur me mjete për ndriçim alternativ, rezerva të konsiderueshme uji, sistem kondicionimi gjatë gjithë vitit, internet, vende çlodhjeje e qëndrimi.<br><br>Aneks 2.61 Infrastruktura e Kolegjit Universitar "Wisdom". |
| **Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave. | Ambientet ku zhvillohet mësimi, brenda kampusit universitar të KUW, gjatë vizitave në institucion, u vu re që janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambjente përfshijnë dy godina, Godina A ku gjenden salla, zyra, laboratorë informatike dhe biblioteka, dhe godina B ku gjenden auditorët e leksioneve të pajisur me kompjutera e projektorë.<br><br>Aneks 2.61 Infrastruktura e Kolegjit Universitar "Wisdom". |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor. | Zyrat e personelit akademik në KUW ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor, kjo e paraqitur në RVB në nivele të larta integrimi të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditore. Gjatë vizitave në godina dhe gjatë diskutimeve me grupe të ndryshme, GVJ mësoi se studentët dhe stafi akademik kanë akses në portalin online ku mund të gjejnë leksionet dhe materialet e nevojshme për studim, forumin dhe notat e provimeve, portal ky mjaft i nevojshëm për zhvillimin e mësimit online gjatë periudhës së pandemisë. *Megjithatë, siç e përmendëm edhe më siper, mbeten ende për tu pajisur sallat e kompjuterave me programet kompjuterike për përpunimin e të* |

| | |
|---|---|
| | *dhënave statistikore.*<br><br>Aneks 1.12 Të dhëna të plota për platformat online etj. |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit. | Në librarinë e KUW ofrohet literatura bazë dhe ndihmëse, në gjuhën shqipe (disa tituj edhe në anglisht) për çdo modul të ofruar në programin e studimit MSh në "Administrim Biznesi".<br>*Nga vizita në Bibliotekë rezultoi se numri ishte i kufizuar dhe disa botime te vjetra (p.sh. literatura e detyruar për "Marrje vendimi dhe zgjidhje problemi" është e vitit 2010).* Megjithatë, studentët dhe pedagogët mund të aksesojnë artikuj të ndryshëm si material mbështetës nëpërmjet abonimit që universiteti ka bërë në PROQUEST.<br><br>Aneks 1.12 Të dhëna të plota për platformat online etj.<br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II).<br>Syllabus Marrje Vendimi dhe Zgjidhje Problemi 2019-2020. |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Biblioteka vë në dispozicion të studentëve tekstet mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe literaturë ndihmëse të nevojshme. Institucioni ka bërë përpjekje për shtimin e fondit të bibliotekës fizike (Aneksi 2.41). *Megjithatë, ai mund të azhornohet me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.*<br>*Përsa i përket hapësirave, biblioteka ndodhet në të njëjtin ambjent me Zyrën e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, duke vështirësuar kështu komoditetin për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.*<br><br>Aneks 2.41 Relacion për Biblotekën KU WISDOM, Lista e blerjeve 2018-2019-2020. |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | Studentët dhe stafi akademik i KUW kanë akses në librarinë online PROQUEST, *por gjatë vizitave në institucion rezultoi se kjo mundësi nuk shfrytëzohej nga studentët me të cilët GVJ zhvilloi takimin.*<br>KUW përfshihet edhe në Bibliotekën Digjitale të mundësuar nga RASH.<br><br>Aneks 1.12 Të dhëna të plota për platformat online etj. |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se KUW ka salla konferencash dhe ambjente studimi në bibliotekë të cilat janë në funksion të studentëve për realizimin e detyrave të kursit, diplomave apo edhe prezantimin e tyre. Megjithatë, GVJ rekomandon që salla e bibliotekës të jetë e ndarë nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore. Gjithashtu, në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit bashkëkohor të saj, vjen në ndihmë edhe laboratori i teknologjisë së informacionit, *i cili duhet të pajiset edhe me programet* |

| | |
|---|---|
| | *statistikore të analizimit të të dhënave, për t'i ardhur në ndihmë studentëve dhe pedagogëve në kërkimet e tyre shkencore.* |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.<br><br>**Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. | Platforma on-line (e-learning) mbetet ende një sfidë për KUW. Megjithatë, studentët dhe stafi akademik kanë akses në portalin online ku mund të gjejnë leksionet dhe materialet e nevojshme për studim, forumin dhe notat e provimeve, portal ky mjaft i nevojshëm për zhvillimin e mësimit online gjatë periudhës së pandemisë.<br><br>Aneks 1.12 Të dhëna të plota për platformat online etj. |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre | Stafi akademik i KUW orienton studentët, sigurisht kur studenti përmbush kriteret e përcaktuara në rregulloren e njësisë kryesore/bazë *(neni 25&26),* të përzgjedhë sipas dëshirës së tij tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë, të zgjedhë udhëheqësin e tij dhe në bashkëpunim më të, të përcaktojë temën kërkimore që do të realizojë për mbrojtje. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale. Tezat e diplomës dhe pedagogët që do të udhëheqin punimin e tyre, përcaktohen nga departamenti pas plotësimit nga studentët të një formulari të unifikuar. Gjatë punës kërkimore për arritjen e objektivave të përcaktuara në realizimin e punimit të diplomës, udhëheqësi asiston gjatë gjithë kohës studentin dhe e mbështet atë për përmbylljen me sukses të saj.<br><br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti).<br>Aneks 3.14 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të temave të diplomave për studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.17 Procesverbal mbledhje departamenti ku diskutohen ceshtje të programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi".<br>Aneks 3.18 Vendim Departamenti për temat orientuese të diplomës, dt 31.01.2020. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të | KUW ka ngritur komisione të përhershme, në nive institucional, të clat janë organe kolegjiale, për të promovuar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Këto komisione janë: |

| | |
|---|---|
| mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | - Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë;<br>- Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe kurrikulën.<br>Gjithashtu, KUW ka ngritur NJSBC-në e cla është organ autonom, institucional dhe i përhershëm, i cili vlerëson periodikisht mbarëvajtjen e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.<br>*GJV, në bazë të gjetjeve gjatë bisedave në IAL me përfaqësues të NJSBC-së dhe stafin akademik, rekomandon që kjo njësi të përfshijë element sasior në pytësorët qe përdor, si edhe të përfshijë në raporte edhe analizën e bërë apo gjetjet nga Koordinatori i Programit, si edhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë në të ardhmen.*<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU WISDOM, nenet 13, 22, 27<br>Aneks 2.26 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.<br>Aneks 2.27 Analizë Vjetore e Fakultetit përgjegjës (vjetore periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.<br>Aneks 2.28 Model Relacioni Semestral i pedagogut.<br>Aneks 2.29 Modele të pyetësorëve të studentëve dhe pedagogëve. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron. | Në nivel të njësisë kryesore dhe bazë, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore dhe Departamenti i Ekonomisë, përgjegjës për programin e studimit, hartojnë raporte vjetore, periodike, të punës mësimore dhe kërkimit shkencor, për të vlerësuar cilësinë e programit të studimit.<br>Dekani, si drejtues i fakultetit, drejton gjithë punën mësimore, shkencore dhe përmirësimin e tyre të vazhdueshme. Përgjegjësi i departamentit të Ekonomisë, si njësi bazë, ka përgjegjësinë e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të masave për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.<br><br>Aneks 2.30 Raporte të takimeve periodike me studentë për mbarëvatjen mësimore.<br>Aneks 2.32 Relacion semestral për pyetësorin e studentëve.<br>Relacion i analizes vjetore nga kordinatorja e programit. |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | Në kuadër të zhvillimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies, KUW organizon leksione të hapura si nga lektorë të huaj dhe vendas. Po ashtu, pjesëmarrja e stafit akademik në projektet e mobilitetit me universitetet e huaja, konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, Konferenca Studentore, mbështesin zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.<br><br>Aneks 2.47 Axhenda e 4-th transnational meeting 17-18.01.2020 Cultural Studies in Business project. |

| | |
|---|---|
| | Aneks 2.51 Axhenda e workshopit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M Nate, Programi i workshopit.<br>Aneks 2.53 Program vjetor i veprimtarisë Kerkimore Shkencore; Leksion i Hapur ne departament i pedagogëve të programit Master i Shkencave në Administrim Biznesi Dr. E.Ceko, Dr.L.Sh.<br>Aneksi 2.54 Relacion trajnimi i studentëve te programit Master i Shkencave në "Split University" në Kroaci, Axhenda e trajnimit. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | KUW përpiqet të rrisë nivelin kërkimor-shkencor të pedagogëve, duke i ndihmuar ata financiarisht për të marrë pjesë në konferenca shkencore (edhe në kuadër të programit ERASMUS, si psh Konferenca Ndërkombëtare "Cultural Studies in Business" edhe pse këtu nuk pati pjesëmarrës nga stafi akademik i angazhuar në programin e studimit) apo bërë botime në Revistën shkencore periodike të kolegjit. *Megjithatë, GVJ rekomandon një përfshirje më të gjerë të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit, me botime edhe në revista të huaja prestigjoze, për të rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Ky kualifikim i personelit akademik do të ndihmonte në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies.*<br><br>Aneks 2.45 Axhenda e Konferencës International Cultural Studies in Business, 9 Maj 2019.<br>Aneks 2.46 Kopje e librit Conference Proceeding Cultural Studies in Business.<br>Aneks 2.49 Revista shkencore WISDOM, botimi fundit. |
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | Në vazhdimësi, personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore dhe Departamenti i Ekonomisë, kualifikohen brenda institucionit, në kuadër të marrëveshjeve me institucione të tjera homologe, përmes diskutimeve, leksioneve të hapura, që i kanë sherbyer trjanimit të stafit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhenies dhe të metodave të reja në mësimdhënie.<br><br>Aneks 2.47 Axhenda e 4-th transnational meeting 17-18.01.2020 Cultural Studies in Business project.<br>Aneks 2.51 Axhenda e workshopit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M Nate, Programi i workshopit.<br>Aneks 2.53 Program vjetor i veprimtarisë Kerkimore Shkencore; Leksion i Hapur ne departament i pedagogëve të programit Master i Shkencave në Administrim Biznesi Dr. E.Ceko, Dr.L.Sh. |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Drejtuesi i departamentit kontrollon vazhdimisht stafin akademik mbi zbatimin e metodave të reja në mësimdhenie. Ky është një detyrim i cili rrjedh nga marrëdhëniet e punës që ka stafi akademik në lidhje me realizimin e procesit mësimor të përcaktuara në kontratën e punës. Në fillim të semestrit, pedagogu harton planin kalendar të zhvillimit të leksioneve dhe seminareve. Pedagogu është përgjegjës për të gjitha zërat e detyrave që ai ka në marrëdhënie me studentët për organizimin dhe zhvillimin e |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e | |

| | |
|---|---|
| pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | mësimit si dhe plotësimin e detyrave që i ngarkon departamenti.<br><br>Aneks 2.27 Analizë Vjetore e Fakultetit përgjegjës (vjetore periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.<br>Aneks 2.28 Model Relacioni Semestral i pedagogut. |
| **Kriteri 8.** Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor | Në Maj 2019 KUW ka organizuar në bashkëpunim me "Irisoft Education" një trajnim lidhur me metodat e reja të mësimdhënies, i pasuar nga një tjetër trajnim në Dhjetor 2019 me tematikë mbi metodat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor (Aneksi 2.51).<br><br>Aneks 2.51 Axhenda e workshopit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M Nate, Programi i workshopit.<br>Aneks 2.52 Relacion trajnimi i Irisoft Education me temë "Formimi i stafit akademik me risitë kurrikulare"; Programi trajnimit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në KUW, se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, teste me alternativa përgjigjesh si dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktura në Rregulloren e Departamentit të Ekonomisë *(nenet 9, 12, 35, 41 dhe jo siç specifikohet në RVB)* dhe në Rregulloren e Programit të studimit *(neni 16 dhe jo 13 siç specifikohet në RVB)*. Kontrolli i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet: angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegiumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës; rastet studimore për problematikën e disiplinës; provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lendës. Sistemi i vlerësimit të studentëve realizohet nëpërmjet sistemit të pikëve 0-100 (*neni 41 i Rregullores së Departamentit*) të cilat konvertohen në nota (4-10). Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studetëve që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve. |

| | |
|---|---|
| | Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti).<br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II). |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Nga dokumentacioni dhe vizita ne institucion konstatuam se pedagogu i lëndës, para fillimit të çdo semestri, bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit. Gjithashtu, i njeh studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës.<br>Grafikët e provimeve shpallen para fillimit të sezonit. Në formën e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë.<br><br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti).<br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II). |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara | Bazuar në Rregulloren e Departamentit të Ekonomisë *(nenet 9, 12, 35, 41)* dhe në Rregulloren e Programit të studimit *(neni 16),* janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që ka përvetësuar studenti gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final, për të testuar sa më realisht njohuritë dhe kompetencat e studentëve.<br>Kontrolli i dijeve të studentëve bëhet sipas kritereve të përcaktuara ku ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive vlerësohet me 10 %, ese ose detyra të kursit vlerësohen me 10 %, dy testimet gjatë vitit me 5-10 % secili (në varësi të lëndës) dhe në fund kryhet provimi përfundimtar, i cili vlerësohet me 60-70 % (në varësi të lëndës).<br><br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti).<br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II). |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. | Nga verifikimet gjatë vizitës në institucion, u konstatua që vlerësimi i njohurive, aftësive dhe dijeve të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe studentët janë njohur për të në rregulloren e Fakultetit dhe rregulloren e Departamentit. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë: Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit dhe vlerësimi përfundimtar. Nota përfundimtare del si rezultat kumulativ i pikëve të vlerësimit të vazhduar dhe provimit përfundimtar.<br><br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti).<br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II). |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Për zbatimin e këtij kriteri, KUW përdor një sistem elektronik, portalin e studentit, i cili mundëson testimin dhe vlerësimin online të studentëve, për të rritur transparencën në vlerësim.<br><br>http://portal.hstalb.xyz/ |
| **Kriteri 3.** Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | Përgjegjësi i departamentit miraton modalitetet e testimit të dijeve. Komisionet e provimeve, kanë së paku dy anëtar, ku njëri është titullari i lëndës/modulit.<br><br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti). |
| **Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie. | Bazuar në rregulloren e sekretarisë mësimore (neni 24) të KUW, fletët e provimit plotësohen nga sekretaria, firmosen nga dekani i fakultetit dhe kryesekretari, dhe mbajnë vulën e institucionit. Fletët e provimit sekretohen (*neni 26 i rregullores së sekretarisë mësimore*) dhe studenti futet në provim me letërnjoftim.<br><br>Aneks 1.05 Rregullore e sekretarisë mësimore.<br>Aneks 2.43 Model i Testit të pjesshëm, Model i testit përfundimtar, Formular i vlerësimit të vazhduar. |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Gjatë takimit me studentët u informuam që ata orientohen që në fillim të lëndës nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korrespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursi apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët. Një procedurë e tillë mundëson marrrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Komisionet e provimeve në KUW kanë së paku dy anëtar, ku njëri është titullari i lëndës/modulit. Personeli akademik që ndjek procesin e provimit u ndalon hyrjen në provim personave të jashtëm dhe merr masa për të shmangur çdo formë kopjimi. Studentët që në provim përdorin forma e mjete të palejueshme përjashtohen nga provimi. Bazuar në nenin *69, pika d) të rregullores së KUW dhe nenin 70* i kësaj rregullore, merren masat disiplinore përkatëse. Përsa i përket temave të diplomave udhëheqësi mban kontakte të vazhdueshme me studentin si dhe i kërkon informacion të detajuar për literaturën e përdorur në secilën nga pjesët e punimit dhe mënyrën e referimit të saj, me qëllim shmangien e plagjiaturës.<br><br>Aneks 1.02 Rregullore e KU WISDOM.<br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti). |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Procesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Gjatë procesit të kontrollit stafi shënon pikët për çdo ushtrim si dhe tregohet i kujdesshëm të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të lëndës/modulit. Rezultatet e provimit hidhen në proceverbale dhe dorëzohen në sekretari brenda 5 ditëve *(neni 20 pika 2, e rregullores së programit) dhe* 15 ditëve nga data e provimit *(neni 26 i rregullores së sekretarisë mësimore)*.<br><br>Aneks 1.05 Rregullore e sekretarisë mësimore.<br>Aneks 3.02 Studimi i tregut të punës para hapjes së programit "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi". |
| **Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Pas shpalljes së rezultateve, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda 72 orëve *(neni 20 i rregullores së programit)*. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Pas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit dhe dorëzimin e tij në sekretarinë mësimore. Provimet me shkrim të studentëve ruhen nga pedagogu i modulit për një periudhë gjashtë mujore pas përfundimit të sezonit të provimeve.<br><br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet | Studenti ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimeve ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Kjo ankesë shqyrtohet nga përgjegjësi i departamentit, komisioni i vlerësimit dhe më pas |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| dhe arkivohet | komisioni i posaçëm, ku vihet në dijeni edhe dekani. Dekani ngre komisionin e posaçëm dhe përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Ndryshimi pranohet brenda 3 ditëve (72 orëve) nga dhënia e provimit *(neni 20 i rregullores së programit).*<br><br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.7**<br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë sipas udhëzimit 41, nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të menaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit.<br>*GVJ konstaton siç kemi përmendur edhe më lart, se ky programi i jep një peshë dhe pozicion të veçantë lëndës së "Drejtimit Financiar i Avancuar", "Ekonomiks Manxherial" dhe "SIM", duke i konsideruar si lëndë bazë të detyrueshme për këtë program studimi, ndërkohë që lëndë të tilla sipas mendimit të GVJ mund të konsideroheshin "Menaxhimi i Projekteve dhe Kontratave" apo "Menaxhim i Ndryshimit" aktualisht pozicionuar tek lëndët ndërdisiplinore, lëndë të cilat janë të një rëndësie të veçantë në ditët e sotme.*<br>*Gjatë takimeve me studentët e programit dhe sekretarinë mësimore, rezuloi se ata nuk kanë dijeni që programi ka edhe lëndë me zgjedhje. Praktikisht, kategoria C e lëndëve me zgjedhje nuk i ofrohet studentëve, pasi ato janë ofruar si lëndë të detyrueshme, duke cënuar kështu mundësinë e studentit të thellohet më tepër në një specialitet që dëshiron brenda fushës së gjerë të menaxhimit.*<br><br>Aneks 3.05 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi".<br>Aneks 3.10 Orari Mësimor.<br>Aneks 3.11 Propozimi për miratimin e lëndëve me zgjedhje Nr. Prot 39022, dt. 01102019.<br>Aneks 3.11 Vendimi i lëndëve me zgjedhje Nr. Prot 39023, dt. 01102019. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të | Në zbatim të *VKM 41, datë 24.1.2018*, GVJ konstatoi se modulet |

| | |
|---|---|
| veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | janë të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse. *Por, Lënda "SIM" e kategorizuar në program si Lëndë Bazë e Detyrueshme, i përket sipas VKM 41, datë 24.1.2018 kategorisë D (Lëndë Plotësuese, njohuri kompjuterike).*<br><br>Aneks 3.05 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi". |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. | Nga verifikimi i syllabuseve, GVJ konstatoi se në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulin përkatës. Sipas RVB dhe vizitave ne institucion, pedagogët dhe studentët diskutojnë së bashku njohuritë dhe aftësitë e fituara në përfundim të lëndës, të cilat paraqiten në raportet semestrale të pedagogëve.<br><br>Aneks 2.28 Model Relacioni Semestral i pedagogut.<br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II). |
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar. | Në fund të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim.<br><br>Aneks 2.43 Model i Testit të pjesshëm, Model i testit përfundimtar, Formular i vlerësimit të vazhduar. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Në këtë program studimi organizohen (siç është përmendur dhe më lart) leksione të hapura nga personeli akademik dhe lektorë të ftuar për tema të veçanta dhe që janë me interes për studentët, si edhe vizita studimore në institucione apo biznese.<br><br>Aneks 2.51 Axhenda e workshopit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M Nate, Programi i workshopit.<br>Aneks 2.53 Program vjetor i veprimtarisë Kerkimore Shkencore; Leksion i Hapur në departament i pedagogëve të programit Master i Shkencave në Administrim Biznesi Dr. E.C, Dr. L.Sh. |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që ti pajisin studentët me aftësi për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurrikula e programit të studimit dhe plani mësimor, i lë në semestrin e dytë hapësirë angazhimit të tyre në praktikën profesionale. Kjo u jep mundësi studentëve për të zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.<br><br>Aneks 3.05 Programi Mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i |

| | |
|---|---|
| | Shkencave" në "Administrim Biznesi". |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. | Syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Ato synojnë që të krijojë tek studentët mundësinë për të analizuar një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut.<br><br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II). |
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.<br><br>**Kriteri 9.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Institucioni ka krijuar infrastrukturën e nevojshme të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet edhe financiarisht aktivitete të tilla si organizimi i Konferencës Studentore apo revistës shkencore periodike WISDOM. *Megjithatë, duke u bazuar në vizitat dhe takimin me studentët, GVJ konstatoi se numri i pjesëmarrjes është i vogël dhe konsiton në prezantim dhe jo ndonjë punim shkencor. Si rrjedhim, GVJ rekomandon që personeli akademik duhet të nxisë dhe përfshijë më tepër studentët e masterit shkencor në studime e në punë kërkimore-shkencore.*<br>*Gjithashtu, në të ardhmen, sugjerohet që institucioni të organizojë edhe konkurse të formatit Start-up weekends ku studentët të mund të prezantojnë idetë e tyre novatore.*<br><br>Aneks 2.48 Axhenda e Konferencës Studentore ndëruniversitare, 24 Prill 2019.<br>Aneks 2.63 Vendim departamenti për trajnimin 3-ditor të studentëve në Split Kroaci. |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve | Për rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe për tu dhënë atyre aftësi praktike, personeli akademik i departamentit, në vazhdimësi ka ndërthurur format e mësimdhënies me vizita në institucione të tjera brenda vendit më të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.<br>*Nga takimi në institucion me stafin akademik dhe studentët, na u komunikua që nuk ka pasur interes nga studentët master për mobilitetin në kuadër të marrëveshjeve që ka KUW, pasi ata janë edhe në marrëdhënie pune, ose kërkohej njohuri shumë e mirë e gjuhës italiane.*<br><br>Aneks 2.23 Relacioni mbi Aktivitetin e Projeketeve kombëtare dhe ndërkombëtare të KU Wisdom, FSHESH. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Standardi III.8<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Kriteret dhe procedurat e diplomimit përcaktohen në *Rregulloren e Programit, neni 17* dhe *Rregulloren e Fakultetit, neni 15*. Detajet dhe kërkesat për përgatitjen e punimit të Diplomës, i vlerësuar me 30 kredite ECTS, jepen në Rregulloren mbi Punimin dhe mbrojtjen e Diplomave *(Aneksi 3.14)*. Sipas Rregullores së programit *(neni 15),* studentët e masterit shkencor mund të diplomohen duke punuar dhe mbrojtur një temë diplome, vetëm pasi të kenë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët dhe praktikë. Ky është viti i parë i të diplomuarve të këtij programi.<br><br>Aneks 2.05 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.<br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti).<br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.14 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të temave të diplomave për studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | Struktura përgjegjëse e këtij programi është Departamenti i Ekonomisë, i cili sipas rregullores dhe atyre që konstatuam, i bën të ditur studentëve kriteret e diplomimit. Për këtë angazhohet stafi akademik. Sipas kritereve, studenti depoziton kërkesën pranë departamentit për tu listuar në listën e studentëve për mbrojtje diplome. Në kërkesë ai parashtron temën e diplomës brenda fushës së studimit dhe propozon pedagogun udhëheqës. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat e studentëve, mbi bazën e të cilave harton listën e studentëve që plotësojnë kriteret për të përgatitur një punim diplome dhe udhëheqësin dhe ja paraqet për miratim Dekanit të Fakultetit. Drejtuesit e temave të diplomës për të gjithë studentët e listuar që plotësojnë kriteret, miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Formati i paraqitjes së punimit të diplomës eshte përcaktuar në rregulloren e programit.<br><br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti).<br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.14 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të temave të diplomave për studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.18 Vendim Departamenti për temat orientuese të diplomës, dt 31.01.2020. |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, | Ky program studimi nuk parashikon Provimi Final, por mbyllja e tij konsiston në punimin dhe mbrojtjen e diplomës, të specifikuar më lart. |

| | |
|---|---|
| duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti).<br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave. | Nga takimet me studentët dhe stafin, GVJ konstatoi që udhëheqësi i punimit të diplomës orienton dhe ndihmon studentin për pergatitjen e temës së diplomës. Së bashku, përgatisin programin e punës së studentit, afatet gjatë të cilave ndihmohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar.<br><br>Aneks 3.14 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të temave të diplomave për studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.18 Vendim Departamenti për temat orientuese të diplomës, dt 31.01.2020. |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | GVJ vlerësoi nga takimet se studentët e programit të studimit, e përdorin shumë pak bibliotekën e institucionit. Laboratorët e teknologjisë së informacionit kanë mjedise të mjaftueshme dhe kompjutera të cilat studentët e këtij programi studimi, mund t'i përdorin për përgatitjen e temave të diplomave. *Sugjerohet që ato të pajisen me programe kompjuterike statistikore për të ndihmuar studentët në përpunimin e të dhënave.*<br><br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.14 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të temave të diplomave për studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Nga verifikimet dhe vizita ne institucion u konstatua se pedagogu udhëheqës i temës përgatit metodikën e studimit për realizimin e temës së diplomës dhe mbi bazën e saj organizohet e gjithë puna kërkimore që duhet të kryejë studenti, duke i dhënë atij të gjithë asistencën e nevojshme për realizimin e punimit të diplomës nga fillimi i kërkimit deri në shkrimin e raportit të punimit, duke garantuar në këtë mënyrë cilësinë e tij. Gjithashtu, udhëheqësi në përfundim të punimit harton një raport të shkurtër me anë të të cilit e miraton atë, ose në rastet kur studenti nuk i është përmbajtur kritereve dhe udhëzimeve të tij nuk e miraton, ose i ben vërejtjet për përmirësim. Këtë raport ai ja paraqet komisionit të vlerësimit dhe dekanatit, së bashku me punimin e temës së diplomës.<br><br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesore bazë (Departamenti).<br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.14 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të temave të diplomave për studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi. |

| | |
|---|---|
| | Aneks 3.18 Vendim Departamenti për temat orientuese të diplomës, dt 31.01.2020. |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Studentët vlerësohen me notë për mbrojtjen e diplomës. Ky është viti i parë i diplomantëve nga ky program dhe nuk ka ende evidenca procesverbalesh në sekretarinë mësimore.<br><br>Aneks 3.14 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të temave të diplomave për studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Në përfundim të këtij program studimi studentët do të pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës.<br><br>Aneks 3.15 Suplementi i Diplomës "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi Nr. Prot 6741, datë 13.04.2018.<br>Aneks 3.16 Modeli i Diplomës "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi". |
| **Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Kopja e plotë e programit të zhvilluar të studimeve u jepet studentëve me depozitimin e një kërkese.<br><br>Aneks 1.05 Rregullore e sekretarisë mësimore.<br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimit të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen | GVJ konstatoi që dokumentacioni për studentët në vite është i plotë, por ka ende studentë të pamatrikuluar. Sekretaria mësimore na vuri në dispozicion kërkesën që ka bërë në Institucionin përkatës për matrikulimin e studentëve. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e | KUW çdo vit akademik mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit përgjegjës për organizimin e programit të studimit MSHAB, personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe të personelit ndihmës akademik të angazhuar në këtë program |

| | |
|---|---|
| personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. | studimi. Nëpërmjet konsultimit të dosjeve të stafit të përzgjedhur në mënyrë rastësore u konstatua se dokumentacioni i mbledhur dhe ruajtur nga zyra e Burimeve Njerëzore konsiston në: Librezë pune; Kërkesë; Formular vetëdeklarimi; Deklaratë konfidencialiteti; Fotokopje ID; Deklaratë; Raport Mjeko-Ligjor; Librezë shëndetësore; Librezë pune; Diploma të noterizuara, etj.<br><br>Aneks 2 16-17-18-19 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.<br>Aneks 2.35 Formati i Dosjes personale të stafit. |
| **Kriteri 2.** Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit | Procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të hartuara në përputhje me bazën ligjore dhe të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e brendshme të KUW.<br>Personeli përzgjidhet me konkurim sipas fazave:<br>1. Identifikimi i nevojave për staf akademik;<br>2. Shpallja e vendeve të lira;<br>3. Shqyrtimi i dosjeve dhe intervistimi;<br>4. Punësimi dhe procedura administrative.<br>Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për staf akademik përcaktohen nga Departamenti përkatës dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Fillimisht kandidatët aplikojnë me dosje pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore. Kandidatët e përzgjedhur nga zyra, njoftohen më pas për fazën e dytë të konkursit. Gjatë fazës së dytë, kandidatët intervistohen dhe përzgjidhen nga Komisioni i Vlerësimit ad-hoc. Kandidaturat e përzgjedhura me kohë të plotë i dërgohen për kompetencë Dekanit, i cili ia propozon për miratim Rektorit, ndërkohë kandidaturat e kandidatëve me kohë të pjesshme i dërgohen për shqyrtim Departamentit dhe më pas për miratim Dekanit të Fakultetit.<br>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se këto procedura janë pjesë e akteve rregullatore dhe aplikohen nga institucioni në përzgjedhjen e stafit akademik.<br>Referuar njoftimeve në faqen web të institucionit, konstatohet se KUW bën publike thirrjet për punësim të stafit akademik efektiv dhe me kontratë. Gjithashtu institucioni shpall këto thirrje edhe në ambientet e tij.<br>Në këtë thirrje rezulton e publikuar edhe procedura si dhe metodologjia e vlerësimit nga komisioni ad hoc.<br><br>Aneks 2.34 Politikat e rekrutimit të personelit akademik në KU "WISDOM", Modeli i skedës vlerësuese të kandidatëve.<br>https://Wisdom.edu.al/njoftime/articles/NJOFTIM34 |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | KUW angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Institucioni ka vënë në dispozicion të stafit akademik një godinë me sipërfaqe 418 m2, e pajisur me kompjuter, printer, fotokopje, internet, etj. Por ndërkohë, Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, siç përmendet edhe më lart, rezulton të operojë në ambjentet e bibliotekës. *Si rrjedhim, GVJ, rekomandon që institucioni të sigurojë një ambjent të veçantë dhe të përshtatshëm për aktivitetin e zyrës. Në këtë zyrë janë të arkivuara informacione dhe dosje të rëndësishme të institucionit ku nuk duhet të kenë akses studentë apo punonjës të tjerë.*<br><br>Aneks 2.61 Infrastruktura e Kolegjit Universitar "Wisdom". |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | KUW mbështet stafin akademik të MSHAB për zhvillim të mëtejshëm profesional, nëpërmjet pjesëmarrjes pa pagesë në konferencat e organizuara nga institucioni, botimet në revistën Wisdom dhe botime libri si p.sh. Libri "Manaxhim Total Cilësie". Gjithashtu, institucioni ka depozituar pas vizitës në institucion, dokumenta lidhur me alokimin e fondeve për kërkimin shkencor në departamentet e institucionit. *Ndërkohë, evidenca lidhur me shpërndarjen dhe politikën që institucioni ka ndjekur në alokimin e këtyre fondeve midis stafit të programit nuk janë paraqitur.*<br>*Ekspertët rekomandojnë që institucioni të hartojë politika motivuese e stimuluese për stafin akademik të programit drejt një kërkimi shkencor të vazhdueshëm, duke mos e limituar vetëm me mundësitë institucionale, por zgjeruar edhe me pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare dhe publikime në revista shkencore prestigjoze jashtë vendit.*<br><br>Aneks 2.50 Libri Manaxhim Total Cilësie, botuar nga pedagogët e KU WISDOM, Prof.Asoc.Dr.N.M dhe Dr.E.C.<br>Procedura për kërkimin shkencor, kërkesë për fond, Vendim për alokim fondi. |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | KUW ka organizuar një trajnim dy-ditor (i ftuar një pedagog i huaj) si edhe një workshop në bashkëpunim me IRISOFT me fokus metodat inovative të mësimdhënies si dhe përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik të programit MSHAB. |

| | |
|---|---|
| | Aneks 2.51 Axhenda e workshopit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M Nate, Programi i workshopit.<br>Aneks 2.52 Relacion trajnimi i Irisoft Education me temë "Formimi i stafit akademik me risitë kurrikulare"; Programi trajnimit. |
| **Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë | Referuar strukturës organizative si dhe vizitës në KUW, institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore, kryesisht stafit akademik, për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve MSHAB. Ndërkohë, për stafin ndihmës akademik dhe atë administrativ, vihet re mbivendosje të detyrave dhe lind nevoja për një riorganizim dhe ndarje detyrash më specifike.<br><br>Aneks 2 16-17-18-19 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.<br>Aneks 2 13 CV e stafit akademik të programit të studimit.<br>Aneks 2 15 CV e stafit ndihmës akademik. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Referuar evidencave si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se KUW disponon laborator informatike me 25 PC, auditorë për leksione dhe seminare si dhe një sallë konferencash me kapacitet 120 vende, mjedise këto të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, si dhe në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit MSHAB.<br><br>Aneks 2.61 Infrastruktura e Kolegjit Universitar "Wisdom". |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.<br><br>**Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, | Nga informacioni i vënë në dispozicion dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni disponon 12 salla për seminare dhe leksione me sipërfaqe prej 636 m$^2$, të pajisura me projektorë dhe tabela. Ekspertët konkludojnë se këto mjedise janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimit të programit MSHAB, por ndërkohë, sikurse përmendur edhe më herët, rezulton që *laboratori i teknologjisë nuk është i pajisur me programe softwarike të nevojshme për përpunimin dhe analizimin e të dhënave të mbledhura gjatë kërkimit shkencor. GVJ* |

| | |
|---|---|
| përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | *rekomandon që KUW të pajisë laboratorin e teknologjisë me programe softwarike, si psh. SPSS apo EViews, të nevojshme për përpunimin dhe analizimin e të dhënave gjatë kërkimit shkencor si të stafit akademik ashtu dhe të studentëve.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Aneks 2.61 Infrastruktura e Kolegjit Universitar "Wisdom". |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike | KUW bashkëpunon me institucione publike dhe private të tjera për zhvillimin e praktikave profesionale si dhe veprimtarive të tjera praktike. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme për të realizuar praktikat profesionale të studentëve, ndër të cilat vlen të përmenden marrëveshjet me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Irisoft Education, R&T Group, Nettrade Albania, etj.<br><br>Aneks 2.22 Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | KUW ka vënë në dispozicion të studentëve të programit MSHAB bibliotekën mësimore dhe ju garanton atyre mundësi të barabartë shfrytëzimi. Biblioteka ofron 45 poste pune në shërbim të studentëve dhe stafit të institucionit si dhe është e pajisur me 12 laptopë dhe akses internet, të nevojshme për kërkim shkencor, përgatitjen e detyrave të kursit apo punimin e tezava të masterit. Përveç studimit dhe kërkimit, salla e bibliotekës u vjen në ndihmë studentëve edhe për fotokopje të materialeve në nevojë. |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Gjatë vizitës në institucion si dhe referuar dokumentacionit të depozituar nga IAL, GVJ konstaton se biblioteka e KUW është e pajisur në literaturë si tekste mësimore bazë dhe literaturë ndihmëse me rreth 1271 tituj fizikë, 3326 libra fizikë, si dhe 64862 periodikë, revista/buletinë shkencorë në shqip dhe gjuhë të huaj. *Por GVJ konstaton se kjo literaturë është relativisht e vjetër.* Gjithashtu, ky fakt konstatohet edhe në blerjet e fundit të bibliotekës në vitet 2018-2019-2020, ku *një pjesë e literaturës i* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | *përket botimeve përpara viteve 2015 dhe 2010.*<br>*GVJ rekomandon që institucioni të pasurojë literaturën e bibliotekës me nje gamë më të gjerë botimesh bashkëkohore librash në gjuhën shqipe dhe angleze, si libra, revista shkencore e periodikë përtej botimeve institucionale relevante për programin e studimit MSHAB.*<br><br>Aneks 2.41 Relacion per Biblioteken KU WISDOM, Lista e blerjeve 2018-2019-2020. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | KUW u siguron studentëve të programit të studimit MSHAB kushte për akses të barabartë dhe pa pagesë në bibliotekat on-line ProQuest dhe Cobiss. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në shfrytëzimin online të faqeve elektronike të këtyre bibliotekave të instaluara tek laptopët e sallës së bibliotekës, si dhe jashtë ambienteve të institucionit nëpërmjet websitit të KUW. Biblioteka elektronike ProQuest ju ofron studentëve dhe stafit akses në libra, revista, raste studimore dhe publikime të ndryshme. Ndërkohë aplikacioni elektronik Cobiss.al u mundëson aksesin në regjistrimet bibliografike për libra e artikuj të ndryshëm.<br>Biblioteka e KUW është e pajisur me laptop të cilët u mundësojnë studentëve aksesin e informacioneve të kërkimit si dhe punimin e detyrave të kursit. Biblioteka operon me një orar të zgjatur që është në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave të studentëve të programit të studimit MSHAB.<br><br>Aneksi 2.42 Kontratë me ProQuest; Kontratë me platformën online Cobiss. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Referuar vizitës në institucion, GVJ konstaton se informacioni lidhur me studentët e programit të studimit MSHAB mbahet nga sekretaria mësimore me anë të regjistrave manualë.<br>Ndërkohë të dhënat dhe dokumentacioni i personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, mbahet në dosje nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore.<br>*GVJ rekomandon që institucioni të investojë në implementimin e një sistemi informativ më efektiv dhe efiçent, i cili të mundësojë* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit | |

| | |
|---|---|
| akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | *integrimin në nivel institucional të informacionit:*<br>- të studentëve me aktivitetet e tyre nga regjistrimi deri në diplomim;<br>- të aktiviteteve të stafit dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit;<br>- i cili siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente si për personelin ashtu edhe për studentët e programit të studimit;<br>- garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ;<br>- mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimet me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatuan se KUW mundëson komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit personelit akademik dhe studentëve nëpërmjet emaileve zyrtare dhe portalit të studentit. Në portalin e studentit stafi akademik ngarkon leksionet në opsionin "Materialet e Pedagogut" dhe në opsionin "Forum" zhvillon diskutime me studentët. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe | *GVJ konstaton se informacionet lidhur me programin e studimit MSHAB, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit vetëm në gjuhën shqipe. Ekspertët rekomandojnë që institucioni të mundësojë publikimin e informacioneve lidhur me programin e studimit edhe në gjuhën angleze.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Referuar dokumentacionit të depozituar dhe RVB, ekspertët konstatojnë se KUW harton një raport financiar të kostove dhe planin për mbështetjen financiare të detajuar për mbarëvajtjen institucionale. Ky plan financimi institucional përmban kostot e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të | |

| | |
|---|---|
| përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij. | bibliotekën si dhe detyrime të tjera financiare.<br>*GVJ rekomandon që institucioni të hartojë raporte financiare si dhe planin për mbështetjen financiare të detajuar për programin e studimit MSHAB referuar kohës të këtij cikli studimi 2-vjeçar.*<br>Aneks 2.58 Projekt buxheti 2019-2020.<br>Aneks 2.59 Tabela e Raportit financiar të tri viteve të fundit. |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.<br>**Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen | Referuar RVB dhe dokumentacionit të depozituar, ekspertët konstatojnë se raportimi financiar i KUW, përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave dhe institucioni i nënshtrohet kontrollit të Degës së Tatim Taksave. *Por, bazuar në kriterin 3, GVJ rekomandon që institucioni, përtej dokumentimit të gjendjes financiare, të vlerësojë edhe efektivitetin e tij financiar. Vihet re se totali i shpenzimeve institucionale ka qenë më i lartë se ai i të ardhurave në vitet 2017 dhe 2019 dhe se KUW duhet të përmirësojë situatën e tij financiare si dhe mundësitë e gjenerimit të të ardhurave të domosdoshme për të garantuar qëndrueshmërinë e tij financiare.*<br>Aneks 2.59 Tabela e Raportit financiar të tri viteve të fundit.<br>Aneks 2.60 Pasqyrat Financiare 2018. |
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | KUW nuk e ka mbyllur ende ciklin e parë të studimeve në programin MSHAB. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.<br><br>**Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.<br><br>**Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.<br><br>**Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit | KUW ka hartuar procedura dhe politika si në nivel institucional, ashtu edhe në nivel fakulteti, departamenti apo programi. Këto procedura e politika mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, duke filluar me orientimin dhe informimin e kandidatëve për studentë dhe deri në diplomimin e tyre. Institucioni pajis kandidatët me një fletëpalosje që përmban informacione për programet e ofruara dhe studentët aktualë dhe Guidën e studentit. Ato garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit të studimit.<br><br>Për çdo vit akademik, institucioni vendos kuota dhe kritere lidhur me pranimin e studentëve në programin e studimit MSHAB.<br><br>Referuar nenit 10 të Rregullores së Programit të Studimit të Ciklit të Dytë MSHAB, Dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore është drejtuesi i programit të studimit MSHAB dhe ka nën përgjegjësi organizimin e konkursit të pranimit të studentëve të rinj (pika j, fq. 3). Ndërsa në nenin 10 po të kësaj rregullorjeje Përgjegjësi i Departamentit të Ekonomisë ka për detyrë të miratojë kriteret e pranimit të studentëve si dhe ndjekjen e zbatimit të tyre (pika e, fq. 4). *Ndërkohë ekspertët konstatojnë që nuk ka evidenca rreth hartimit dhe publikimit të kritereve të veçanta për përzgjedhjen dhe pranimin e kandidantëve në këtë program. Gjatë takimit me Sekretarinë Mësimore, rezultoi se shqyrtimi i dosjeve të aplikantëve si dhe pranimi i studentëve bëhet nga kjo njësi dhe jo nga Komisioni i Pranimit i përcaktuar në Nenin 22, pika c të rregullores së programit. Ndërkohë, pranimi i një studenti nga një fushë tjetër rezulton të jetë proçesuar nga koordinatori i programit, dokument ky i kërkuar institucionit gjatë vizitës. Referuar dokumentave të shqyrtuara, GVJ konstaton se institucioni nuk ka një praktikë të konsoliduar në funksion të proçedurave të përcaktuara në rregulloret e tij.*<br><br>*Gjithashtu, referuar takimit me stafin mësimdhënës, ekspertët konstatojnë se institucioni duhet të vendosë kritere në përzgjedhjen e kandidatëve dhe sidomos të atyre që vijnë nga fusha studimi jo ekonomike apo manaxheriale, pasi ato hasin vështirësi në lëndët e* |

| | |
|---|---|
| | *avancuara të programit si p.sh. Drejtimi Financiar i Avancuar.*<br><br>Aneks 1.02 Rregullore e KU WISDOM.<br>Aneks 1.05 Rregullore e sekretarise mesimore.<br>Aneks 1.06 Rregullore e Zyres se Burimeve Njerezore, Keshillimit te Karrieres dhe Jetes Studentore.<br>Aneks 2.05 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.<br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesorebazë (Departamenti).<br>Aneks 2.08 Rregullore për Transferimin në programet e studimit "Bachelor" dhe "Master i Shkencave".<br>Aneks 2.11 Vendim Senatit "Mbi miratimin e kuotave të pranimit të studentëve me kohë të plotë të programeve të studimit për vitin akademik 2019-2020".<br>Aneks 2.66 Fletëpalosje; Guida e studentit.<br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Rast dhe procedure e nje studenti te nje fushe tjeter studimi. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | KUW ka hartuar procedura dhe politika si në nivel institucional, ashtu edhe në nivel fakulteti, departamenti apo programi. Në këto rregullore institucioni ka përcaktuar kriteret dhe procedurat lidhur me përparimin akademik të studentëve si dhe të kalimit nga një vit akademik në tjetrin.<br>*GVJ rekomandon që institucioni këto kritere dhe procedura t'i bëjë publike në web në mënyrë që të jenë të aksesueshme për studentët.*<br><br>Aneks 1.02 Rregullore e KU WISDOM.<br>Aneks 2.05 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.<br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesorebazë (Departamenti).<br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Neni 69, pika 3 e Statutit të KUW thekson se: *"Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e KU dhe të njësive bazë, në përputhje me kërkesat ligjore" (fq.40).*<br>GVJ konstaton se, në rregulloren institucionale neni 57, pika 6, i referohet kritereve se si studenti mund të kalojë studimet nga një program tjetër studimi i ciklit të dytë në vitin e parë apo të dytë të studimeve në KUW. *Në këtë rregullore nuk janë të përcaktuara kriteret dhe proçedurat për njohjen e krediteve. Ndërkohë, në* |

| | |
|---|---|
| | *rregulloren e njësisë bazë, nuk ka asnjë informacion lidhur me kriteret apo procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimit të studimeve, megjithëse neni 69 i Statutit të KUW përcakton pasqyrimin e tyre.*<br>*GVJ rekomandon që institucioni të përcaktojë kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme në rregulloret e tij, si dhe ti bëjë ato të aksesueshme për studentët nëpërmjet webit institucional.*<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU WISDOM.<br>Aneks 1.02 Rregullore e KU WISDOM.<br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesorebazë (Departamenti). |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Studentët informohen lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve në programin e studimit MSHAB nëpërmjet rregullores së programit si dhe në syllabuset e lëndëve përkatëse. Në javën e parë të çdo semestri, lektori prezanton me detaje lëndën si dhe kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive. Referuar nenit 79 të Rregullores së KUW, vlerësimi bëhet duke u mbështetur në pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, ushtrime, kolegiume, detyra kursi si dhe provimi përfundimtar.<br><br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Syllabus Drejtim Financiar i Avancuar 2019-2020. |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Studentët informohen lidhur me kriteret e procedurat e punimit të tezës së diplomës së programit të studimit MSHAB nëpërmjet rregullores së programit si dhe rregullores mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të temave të diplomave.<br><br>Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimi të Ciklit të dytë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.<br>Aneks 3.14 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të temave të diplomave për studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | Referuar RVB, KUW informon studentët e ardhshëm përmes njoftimeve në: faqen zyrtare, rrjetet sociale, stendat e KUW, publikimit të guides së studentit, pjesëmarrjes në ditë e hapura dhe panairet organizuar nga MASR.<br>*Përveç fletëpalosjes, institucioni nuk ka dorëzuar evidenca të këtyre aktiviteteve. GVJ rekomandon që institucioni të arkivojë dhe analizojë impaktin e aktiviteve institucionale në suksesin e tij.*<br><br>Aneks 2.66 Fletëpalosje; Guida e studentit. |

| **Shkalla e përmbushjes së** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **standardit** | | | X | |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | KUW informon studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet Guidës së Studentit, afishimit të informacioneve në stendat e fakultetit, postimit në web dhe rrjete sociale. Referuar vizitës në institucion, rezulton që studentët informohen gjithashtu edhe nga sekretaria mësimore si dhe nëpërmjet takimeve informuese të organizuara nga Departamenti.<br><br>Aneks 2.66 Fletëpalosje; Guida e studentit. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Në fillim të çdo moduli apo lënde, gjatë javës së parë të semestrit, studentët informohen nga secili pedagog rreth përmbajtjes dhe veprimtarive formuese si dhe u vihet në dispozicion sillabusi përkatës. Gjithashtu studentët aksesojnë informacion të detajuar edhe gjatë takimeve informuese të organizuara nga departamenti dhe Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore.<br><br>Aneks 3.12 Syllabuset (Viti I; Viti II). |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Institucioni ka hartuar një udhëzues karriere të publikuar në web. Në këtë udhëzues student orientohet se si të kërkojë punë, si të përgatisë një CV apo letër motivimi, të përgatitet për një intervistë, etj. *Në RVB përmendet gjithashtu se Specialistja e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore informon studentët mbi mundësitë e punësimit, por institucioni nuk ka raportuar evidenca lidhur me këto aktivitete. GVJ rekomandon që institucioni të arkivojë si dhe publikojë në web jo vetëm aktivitetet e zhvilluara në institucion për orientim drejt tregut të punës, por edhe oferta punësimi lidhur me fushën e studimit.*<br><br>https://Wisdom.edu.al/udhezuesi-i-karrieres |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Në RVB raportohet se studentët informohen rreth zhvillimit dhe organizimit të procesit mësimor, logjistikës, infrastrukturës dhe shërbimeve në funksion nëpërmjet sekretarisë mësimore, departamentit, koordinatores së programit, stendave në institucion, web-it apo rrjeteve sociale. Institucioni nëpërmjet portalit dhe adresës elektronike zyrtare mundëson gjithashtu aksesimin e |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | informacionit edhe për studentët në distancë.<br><br>Aneks 1.05 Rregullore e sekretarise mesimore.<br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesorebazë (Departamenti).<br>www.wisdom.edu.al | | | |
| **Kriteri 6.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve | *Institucioni nuk ka raportuar informacion apo evidenca në RVB lidhur me këtë kriter.*<br>*GVJ nuk konstaton evidenca lidhur me përmbushjen e këtij kriteri.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit. | KUW disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve, të diplomuarve, tërheqjeve si dhe largimeve nga programi MSHAB.<br>Gjatë kontrollit të regjistrit themeltar në zyrën e sekretarisë mësimore gjatë vizitës në institucion, rezulton se numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për vitin akademik 2018-2019 është 21 studentë, nga ku 4 janë ç'regjistruar, ndërsa në vitin akademik 2019-2020 është 18 studentë, nga ku 3 janë ende pa numër matrikullimi. Për këta të fundit ka komunikim me QSHA për pajisjen e tyre me numër matrikullimi dhe janë në pritje.<br>*Ndërkohë, numri i studentëve të paraqitur në aneksin 2.20, nuk përputhet për vitin akademik 2018-2019 pasi rezulton të jetë 18.*<br>*GVJ rekomandon që institucioni të mbajë dhe raportojë statistika të sakta për numrin e studentëve të regjistruar dhe të larguar.*<br><br>Aneks 2.20 Të dhëna të plota për regjistrimin, nota mesatare në hyrje. |
| **Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre. | Referuar vizitës në institucion u konstatua se Sekretaria Mësimore disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit duke filluar që nga pranimi i tyre në hyrje.<br><br>Aneks 2.20 Të dhëna të plota për regjistrimin, nota mesatare në hyrje. |
| **Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e | Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga Sekretaria Mësimore, janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar si dhe gjithashtu janë të aksesueshme nëpërmjet Portalit të Studentit. |

| | |
|---|---|
| autorizuar. | Aneks 1.05 Rregullore e sekretarise mesimore. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve | Fakulteti përgatit raporte vjetore dhe në këtë dokument janë të raportuar studentët dhe cilësia në hyrje si dhe studentët e larguar gjatë vitit 2018-2019.<br>*Por, në këtë raport, nuk është pasqyruar një analizë e cilësisë si dhe arsyeja se përse studentët janë larguar nga institucioni. Gjithashtu, vihet re një ulje në notën mesatare të hyrjes së studentëve nga viti akademik 2018-2019 (7) në 2019-2020 (6.5). GVJ rekomandon që institucioni të hartojë raporte analitike mbi cilësinë e studentëve të regjistruar.*<br><br>Aneks 2.27 Analizë Vjetore e Fakultetit përgjegjës (vjetore periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | KUW ka përfshirë dy studentë si anëtarë të Senatit Akademik, e parashikuar në nenin 14, pika 3 e statutit të KUW, si dhe ka përfshirë një student në NJSBC, e parashikuar në nenin 27, pikën 1 të statutit.<br>*Në RVB raportohet që studentët përfshihen edhe në borde të tjera si Këshilli i Etikës, ndërkohë institucioni nuk ka dorëzuar evidencë për këtë praktikë si dhe neni 26, pika 5 e statutit parashikon që anëtarët e këtij këshilli përbëhen prej personelit akademik.*<br>*Referuar RVB, në përbërje të GVB rezulton të ketë përfaqësues nga studentët e programit, por në takimin me studentët rezultoi se studentja nuk ishte angazhuar me detyra konkrete në hartimin e raportit. Ekspertët rekomandojnë që programi i studimit të përfshijë studentët në procese dhe vendimmarrje lidhur me MSHAB.*<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU WISDOM.<br>Aneks 2.67 Vendimi i emërimit të Studentëve në Senatin Akademik.<br>Aneks 2.68 Vendim për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në | Institucioni, në shpërndarjen e lëndëve si dhe në ngarkesën e tyre të shprehur në kredite, bazohet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra. Në semestrin e parë dhe të dytë studentët ndjekin nga 5 lëndë (30 ECTS) secili semestër. Ndërsa në |

| | |
|---|---|
| programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | semestrin e tretë ndjekin 4 lëndë (24 ECTS) dhe në semestrin e katërt 1 lëndë (6ECTS), praktikën (12 ECTS) dhe punimin e diplomës (18 ECTS).<br><br>*Institucioni ka hartuar një rregullore mbi transferimin e studimeve, por në këtë rregullore nuk janë të përcaktuara kriteret dhe procedurat për njohjen e krediteve. GVJ rekomandon që institucioni të përcaktojë kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme në rregulloret e tij, si dhe ti bëjë ato të aksesueshme për studentët nëpërmjet webit institucional.*<br><br>Aneks 2.06 Rregullore e Njësisë Kryesorebazë (Departamenti).<br>Aneks 2.08 Rregullore për Transferimin në programet e studimit "Bachelor" dhe "Master i Shkencave".<br>Aneks 3.04 Plani mësimor i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi". |
| **Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.<br><br>**Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës | Ekspertët konstatojnë se programi i studimit MSHAB kryen takime periodike me stafin dhe studentët mbi mbarëvajtjen e programit.<br><br>Studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre. Referuar takimeve me stafin akademik, mbas hedhjes së notave, studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit me shkrim brenda 48 orëve pranë përgjegjësit të departamentit. Nëse verifikohet gabim i korigjueshëm, ai së bashku me komisionin e provimit bëjnë korigjimin. Në rast pamundësi zgjidhjeje të ankesës, vihet në dijeni dekani, i cili brenda 48 orësh ngre nje komision ad-hoc për verifikimin e pretendimeve të studentit, i cili rishikon rezultatin.<br><br>Gjithashtu, nëpërmjet anketimeve semestrale, studentët kanë të drejtë të shprehin perceptimet e tyre mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.<br><br>Aneks 2.30 Raporte të takimeve periodike me studentë për mbarëvatjen mësimore. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi V.6**<br>**Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose | Personeli akademik i programit të studimit MSHAB ka marrë pjesë |

| | |
|---|---|
| aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. | në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor si p.sh. Konferenca dhe takimi Ndërkombëtar "Cultural Studies in Business". Gjithashtu, institucioni është partner në një projekt Erasmus+ i titulluar "Cultural Studies in Business", nëpërmjet të cilit janë mundësuar kërkime shkencore të përbashkëta.<br>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, *GVJ rekomandon që institucioni të rrisë bashkëpunimet dhe partneritet me institucionet e huaja të arsimit të lartë për të mundësuar një pjesëmarrje më të gjerë të stafit në aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.*<br><br>Aneks 2.24 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.<br>Aneks 2.33 Relacion për dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.<br>Aneks 2.45 Axhenda e Konferencës International Cultural Studies in Business 9 Maj 2019.<br>Aneks 2.46 Kopje e librit Conference Proceeding Cultural Studies in Business.<br>Aneks 2.47 Axhenda e 4-th transnational meeting 17-18.01.2020 Cultural Studies in Business project. |
| **Kriteri 2.** Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. | |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore. | Personeli akademik ka motivuar studentët e programit të marrin pjesë në Konferencën Shkencore Studentore të organizuar në prill 2019, *por gjatë takimit me studentët e programit në institucion, rezultoi që vetëm një student i programit kishte marrë pjesë, dhe nuk kishte paraqitur një punim shkencor. Ekspertët rekomandojnë që stafi akademik të orientojë dhe suportojë më tepër studentët drejt punimeve shkencore.*<br><br>Aneks 2.48 Axhenda e Konferencës Studentore ndëruniversitare, 24 PRILL 2019. |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve. | *GVJ nuk konstaton evidenca rreth mbështetjes nga ana e institucionit të publikimit të punimeve të personelit akademik dhe studentëve në revista shkencore ndërkombëtare si dhe mbështetjen e studentëve në studime inovative dhe patenta.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave. | |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës | Në takimin me stafin akademik, konfirmohet se u ofrohet asistencë studentëve në kryerjen e analizave dhe përpunimit të rezultateve të punimit të diplomës. Gjithsesi, programi i studimit nuk ka mbyllur ende ciklin e të diplomuarve të parë dhe studentët ende nuk kanë dorëzuar dhe mbrojtur temat e studimit. *Sikurse është përmendur edhe disa herë më sipër, laboratori teknologjik i institucionit* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *gjithashtu nuk ka të instaluara programe softwerike për përpunimin e të dhënave.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi V.7**<br>**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit. | Në planin strategjik të KUW për periudhën 2018-2023 si dhe në rregulloren e NJKSHMJ, parashtrohet politika institucionale për bashkëpunim me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit. *Por, referuar vizitës në institucion si dhe dokumentacionit të depozituar, GVJ, nuk konstaton evidenca të bashkëpunimeve me organizmat shkencorë kombëtarë me fokus rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit.*<br><br>Aneks 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit i KU WISDOM.<br>Aneks 2.07 Rregullore e Njësisë së Kërkimit Shkencor dhe e Marrëdhënieve me Jashtë. |
| **Kriteri 2.** Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve. | Programi i studimit MSHAB, ka të inkorporuar në kurrikulën e tij lëndën "Metodat e Kërkimit Shkencor". *Referuar vizitës në institucion si dhe dokumentacionit të depozituar, GVJ nuk konstaton evidenca të punëve kërkimore nga studentët ku janë implementuar metodat e kërkimit shkencor.* Gjithashtu, siç është përmendur edhe më sipër, *laboratori informatik i institucionit nuk ka të instaluar programe softwerike si SPSS apo EViews të cilat mundësojnë studentët për të bërë analizat e nevojshme ekonomike lidhur për databazën parësore apo dytësore të mbledhur. Ekspertët rekomandojnë që institucioni të marrë masa rigoroze për siguruar vijueshmërinë dhe përgatitjen e studentëve për ciklin e tretë të studimeve.*<br><br>Syllabus Metodat e Kërkimit Shkencor 2019-2020. |
| **Kriteri 3.** Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj. | Institucioni ka përfshirë studentë të programit në projektin kërkimor Erasmus+ "Cultural Studies in Business". *GVJ rekomandon përfshirjen e institucionit në më tepër projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, për të ofruar më tepër mundësi integrimi të studentëve në projekte kërkimore shkencore.*<br><br>Aneks 2.54 Relacion trajnimi i studentëve të programit Master i Shkencave në |
| **Kriteri 4.** Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj. | |

| | |
|---|---|
| | "Split University" në Kroaci, Axhenda e trajnimit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetitin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.<br>**Kriteri 6.** Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore | *Institucioni, aktualisht, nuk ka marrëveshje mobiliteti për shkëmbimin e studentëve*, por ndërkohë evidentohet se KUW ka fituar gjatë vitit 2019 një profesor amerikan i cili ka mbajtur një cikël leksionesh 2-javore. Gjithashtu, në kuadër të projektit Erasmus+ "Cultural Studies in Business", Departamenti ka mundësuar që 3 studentë të programit MSHAB të ndjekin workshopin 3 ditor "Doing Business Across Cultures" në Split University, Kroaci.<br><br>Aneks 2.51 Axhenda e workshopit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M Nate, Programi i workshopit.<br>Aneks 2.54 Relacion trajnimi i studentëve te programit Master i Shkencave në "Split University" në Kroaci, Axhenda e trajnimit.<br>Aneks 2.63 Vendim departamenti për trajnimin 3-ditor të studentëve në Split Kroaci. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi V.8**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.<br>**Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.<br>**Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin | Specialistja e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, operon nën Zyrën e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore. Referuar rregullores së kësaj zyre, specialistja e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore merret me:<br>- Organizimin e strukturave studentore dhe konkretisht senatin studentor, duke siguruar kontributin në realizimin e objektivave.<br>- Organizimin e veprimtarive dhe marrëdhënieve të bashkëpunimit me Institucionet publike dhe private.<br>- Informimin mbi oportunitetet educative për zhvillimin e qëndrimeve dhe aftësive me Projektet Erasmus.<br>- Këshillimin e studentëve që diplomohen.<br>- Organizimin, selektimin dhe rekrutimin e studentëve.<br>- Organizon aktivitete të ndryshme promovuese dhe informuese, panaire, seminare, konferenca të ndryshme.<br>- Informon studentët e ardhshëm për programet e studimit, standartet e pranimit dhe politikat e KUW.<br><br>*GVJ rekomandon që Këshillimi i Karrierës dhe Jetës Studentore të operojë e ndarë dhe në autonomi nga Zyra e Burimeve Njerëzore,* |

| | |
|---|---|
| në tregun e punës. | *të zhvillojë dhe zbatojë një sistem të posaçëm në shërbim të studentëve si dhe të dokumentojë funksionimin e këtij sistemi. Zyra e këshillimit të karrierës duhet të planifikojë dhe të organizojë në mënyrë të vazhdueshme aktivitete informuese dhe orientuese në lidhje me punësimin e ardhshëm të studentëve. Rekomandohet një kombinim më i përshtatshëm midis aktivitetit të zyrave administrative dhe sistemit të këshillimit në bazë të secilit departament. Kjo do të mundësojë ngritjen e një sistemi të përshtatshëm të informimit, këshillimit dhe asistencës së vazhdueshme për studentët.*<br><br>Aneks 1.06 Rregullore e Zyres se Burimeve Njerezore, Keshillimit te Karrieres dhe Jetes Studentore. |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse | Në këtë program studimi nuk është diplomuar ende brezi i parë i studentëve. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | KUW ka të ndërthurur në strukturën e tij Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, funksioni i së cilës është hartuar në përputhje me perspektivat e përgjithshme të përcaktuara nga Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (Shqipëri), duke respektuar kërkesat e përcaktuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, Statutit Institucional (neni 27) dhe Planit |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të | |

<table>
<tr><td>Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</td><td rowspan="3">Strategjik të Zhvillimit Institucional.<br><br>KUW ka hartuar një rregullore të qartë të NJSBC dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, me synim krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.<br><br>Referuar nenit 4, pika 2 të rregullores së NJSBC, sigurimi i cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërjet:<br>a) Strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të KUW, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij;<br>b) NJSBC, e cila vlerëson efikasitetin e veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të KUW dhe harton raportin përkatës të Vlerësimit të Brendshëm.<br><br>NJSBC përbëhet nga 5 anëtarë, nga ku 1 anëtar është përfaqësues i studentëve dhe të tjerët janë përfaqësues të stafit akademik të institucionit. Ndërkohë ekspertë të jashtëm nuk janë përfshirë si anëtarë të kësaj njësie. GVJ rekomandon përfshirjen e ekspertit të jashtëm në këtë njësi për të siguruar një këndvështrim më gjithëpërfshirës, objektiv dhe efektiv të sigurimit të cilësisë në institucion.<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU WISDOM.<br>Aneks 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit i KU WISDOM.<br>Aneks 1.04 Rregullore e Njesise se Zhvillimit te Brendshem te Cilesise.<br>Aneks 2.68 Vendim për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang. institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</td></tr>
</table>

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë. | KUW ka ngritur njësinë NJSBC e cila monitoron, shqyrton, mbikëqyr programet e studimit si dhe përgatit raporte vjetore periodike dhe adreson rekomandime.<br><br>Në kuadër të monitorimit periodik të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit:<br>- çdo pedagog përgatit një relacion semestral në fund të |
| **Kriteri 2.** Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e | |

| | |
|---|---|
| herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.<br><br>**Kriteri 4.** Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.<br><br>**Kriteri 5.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë | semestrit;<br>- njësia organizon pyetësorin për stafin akademik për mbledhjen e opinionit të tyre lidhur me institucionin;<br>- njësia organizon pyetësorin për studentët në fund të semestrit për cilësinë në mësimdhënie dhe procesin mësimor;<br>- njësia zhvillon takime periodike me studentët dhe stafin;<br>- kontroll i befasishëm i zhvillimit të leksioneve dhe seminareve në auditor.<br>Njësia dokumenton rezultatet e këtyre vlerësimeve dhe përgatit raporte të cilët u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. *Referuar takimit me NJSBC si dhe dokumentacionit të konsultuar, ekspertët konstatojnë që njësia përdor një metodologji deskriptive të vlerësimit, të ecurisë dhe mbarëvajtjes së programit të studimit, ndërkohë GVJ rekomandon që elementët e përdorur në pyetësorët drejtuar si studentëve, ashtu edhe stafit të programit, duhen kuantifikuar, në mënyrë që njësia të mund të dalë në konkluzione të sakta dhe të pa manipulueshme. Gjatë takimit me stafin akademik të programit gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatuan hezitime të stafit akademik lidhur me metodologjinë përshkruese dhe jo të kuantifikuar të raportit të përgatitur nga njësia. Gjithashtu ekspertët rekomandojnë që këto raporte të përfshijnë edhe rezultatet e pritshme dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.*<br><br>Aneks 2.26 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.<br>Aneks 2.28 Model Relacioni Semestral i pedagogut.<br>Aneks 2.29 Modele të pyetësorëve të studentëve dhe pedagogëve.<br>Aneks 2.30 Raporte të takimeve periodike me studentë për mbarëvajtjen mësimore.<br>Aneks 2.31 Kalendar i NJSBC për përformancën akademike. Raport të përformancës akademike.<br>Aneks 2.32 Relacion semestral për pyetësorin e studentëve. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | X | | |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i | Referuar dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ, |

| | |
|---|---|
| programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | konstaton se NJSBC kryen vlerësime të brendshme të programit të studimit në mënyrë periodike, i cili është i përfshirë në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike. |
| **Kriteri 2.** Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | Metoda dhe instrumentë të ndryshëm janë përdorur nga njësia për kryerjen e këtij vlerësimi, nga ku mund të përmenden metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës. |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | Gjithashtu, KUW përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si: sondazhe e intervista të studentëve e të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.<br><br>Aneks 2.26 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.<br>Aneks 2.28 Model Relacioni Semestral i pedagogut.<br>Aneks 2.29 Modele të pyetësorëve të studentëve dhe pedagogëve.<br>Aneks 2.30 Raporte të takimeve periodike me studentë për mbarëvatjen mësimore.<br>Aneks 2.31 Kalendar i NJSBC për përformancën akademike. Raport të përformancës akademike.<br>Aneks 2.32 Relacion semestral për pyetësorin e studentëve. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

<table>
<tr><th colspan="5">Standardi VI.4<br>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</th></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th colspan="4">Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</td><td colspan="4" rowspan="5">Referuar nenit 27, pika 1 të Statutit të KUW, NJSBC "përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët përfaqësojnë njësitë kryesore të KUW, këshillin e studentëve, mund të bëjë pjesë dhe 1 anëtar në cilësinë e ekspertit të jashtëm". Aktualisht, të emëruar në këtë njësi, janë 4 akademikë dhe 1 student. GVJ rekomandon përfshirjen e një eksperti të jashtëm në këtë njësi. Gjithashtu, pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.<br><br>Referuar nenit 25 të Rregullores së NjSBC "Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të NjBSC", anëtarët e NjSBC pranë KUW kanë të drejta dhe detyrime të njëjta si kryetari i NjBSC. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Por, siç u përmend edhe më sipër, GVJ rekomandon që njësia të përdorë instrumenta kuantitativë nëpërmjet pyetjeve me shkallë likerti në mbledhjen e të dhënave për vlerësimet në mënyrë që raportimi i tyre të jetë sa më transparent dhe i pamanipulueshëm.<br><br>Aneks 1.01 Statuti i KU WISDOM.<br>Aneks 1.04 Rregullore e Njesise se Zhvillimit te Brendshem te Cilesise.<br>Aneks 2.68 Vendim për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</td></tr>
<tr><th rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</th><th>Nuk përmbushet</th><th>Përmbushet pjesërisht</th><th>Përmbushet kryesisht</th><th>Përmbushet plotësisht</th></tr>
<tr><td></td><td>X</td><td></td><td></td></tr>
</table>

<table>
<tr><th colspan="2">Standardi VI.5<br>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</th></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</td><td rowspan="4">Ekspertët konstatojnë se KUW ka të publikuar në faqen e tij web statutin, rregulloren dhe raportin vjetor të NJSBC për vitin akademik 2018-2019. Raporti i NJSBC është hartuar duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. NJSBC si strukturë nuk harton plan masash në raportin vjetor, por del me rekomandime të cilat u prezantohen Senatit të KUW, i cili i analizon, diskuton dhe përcakton drejtimet kryesore për zgjidhjen e problemeve dhe sugjerimeve të paraqitura në raport. Por, GVJ nuk evidenton raporte vlerësuese për përmirësime të problematikave të mëparshme qoftë të programit apo institucionit. GVJ rekomandon që institucioni të hartojë raporte në bazë programi të cilat të bëhen publike. Në këto raporte duhet të përfshihen mangësitë dhe dobësitë e evidentuara, plan programi i cili adreson përmirësimin e tyre si dhe gjithashtu të raportojë vlerësimet e përmirësimit të këtyre mangësive dhe dobësive të evidentuara në periudhat e ardhshme.<br>KUW duhet të marrë masa për të siguruar efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, dhe impakti i tyre të jetë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.<br><br>https://Wisdom.edu.al/rregullorja-dhe-statuti</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</td><td>Ekspertët konstatojnë se KUW organizon takime periodike me stafin dhe studentët lidhur me mbarëvajtjen mësimore dhe fokus ndërgjegjësimin për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.<br><br>Aneks 2.30 Raporte të takimeve periodike me studentë për mbarëvatjen mësimore.</td></tr>
</table>

<table>
<tr><th rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</th><th>Nuk përmbushet</th><th>Përmbushet pjesërisht</th><th>Përmbushet kryesisht</th><th>Përmbushet plotësisht</th></tr>
<tr><td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr>
</table>

<table>
<tr><th rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</th><th>Nuk përmbushet</th><th>Përmbushet pjesërisht</th><th>Përmbushet kryesisht</th><th>Përmbushet plotësisht</th></tr>
<tr><td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr>
</table>

## Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë

## Master i Shkencave në "Administrim Biznesi", të ofruar nga Kolegji Universitar "WISDOM"

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Orientimi i KUW drejt mbështetjes ndaj studentëve të programit që nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tyre.
2. Përgatitja dhe eksperienca e stafit akademik të angazhuar në program, janë një vlerë e shtuar për programin e studimit.
3. Vënia në dispozicion e burimeve online të bibliotekës për studentët dhe stafin akademik.

**Pika të dobëta:**

1. Mungon një studim i mirëfilltë i tregut të punës ku të analizohen nevojat e tregut të punës sot dhe identifikimi i atyre moduleve/lëndëve të reja që do të pasuronin kurrikulën e programit të studimit. Metodologjia mbi të cilën është ndërtuar ky studim nuk arrin të pasqyrojë problematikat dhe nevojat e bizneseve të vendit, pasi nuk janë reflektuar evidenca nga të dhëna parësore apo dytësore të mbledhura nga tregu, si dhe nuk mund të identifikojë nevojat në dije, aftësi, shkathtësi e kompetenca të tregut e të lehtësojë punësimin e studentëve.
2. Nuk zbatohet plotësisht VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, i ndryshuar, për ofrimin e lëndëve me zgjedhje të cilat pavarësisht se në planin mësimor rezultojnë lëndë më zgjedhje, aktualisht janë ofruar si lëndë të detyrueshme, duke kufizuar kështu diversifikimin e njohurive sipas preferencave të studentëve. Gjithashtu, mungon zhvillimi i ndonjë lënde në gjuhën angleze.
3. Pjesa më e madhe e titullarëve të lëndëve (me përjashtim të lëndëve "Menaxhim Operacionesh" dhe "SIM") nuk i përkasin kategorisë "Profesor", sikurse parashikuar në nenin 59, pika 3, të Ligjit 80/2015.
4. Mungojnë raporte analitike dhe të dhëna sasiore të përpunuara për të analizuar sigurimin e cilësisë në mësimdhënie *për programin e studimit MSHAB*, lidhur me:
   - arritjet dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit;
   - cilësinë e studentëve të regjistruar në program. Nuk është pasqyruar një analizë e cilësisë apo arsyet e largimit të studentëve, si dhe vihet re një ulje në notën mesatare të hyrjes së studentëve nga viti akademik 2018-2019 (7) në 2019-2020 (6.5);
   - efektivitetin financiar dhe planin për mbështetjen financiare referuar kohës së këtij cikli studimi 2-vjeçar.
5. Mungon një plan-buxhet i detajuar me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe kriteret e financimit për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, si dhe nuk disponohet një procedurë transparente për alokimin e fondeve në kuadër të kërkimit shkencor.

6. Njohuri e ulët e studentëve me metodat e kërkimit shkencor dhe përfshirje e ulët e personelit akademik dhe studentëve në aktivitete dhe botime shkencore. Mungojnë mekanizma për mbrojtjen e pronësisë intelektuale si në detyrat e kursit dhe punimet e tezës së diplomimit të studentëve, ashtu dhe në botimet e revistës institucionale “Wisdom”.
7. Probleme drejtshkrimore dhe teknike në një pjesë të rregulloreve, si p.sh. Rregullorja e Programit të Studimit. Gjithashtu, ka mospërputhje midis rregulloreve të ndryshme, psh. *“Rezultatet e provimit hidhen në proceverbale dhe dorëzohen në sekretari brenda 5 ditëve”* (neni 20, pika 2, rregullorja e programit të studimit) dhe *“15 ditëve nga data e provimit”* (neni 26, rregullorja e sekretarisë mësimore).
8. Fondi fizik i bibliotekës është i kufizuar në numër dhe botime të reja.
9. Programet kompjuterike janë me mungesa, si p.sh. programet kompjuterike SPSS, SAS, etj.
10. Mungon përfshirja e stafit të pavarur dhe përfaqesuesit të studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.
11. Nuk ka kritere specifike në përzgjedhjen e studentëve që vijnë nga fusha të tjera studimi, mungojnë procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme në rregulloret e departamentit dhe të programit, edhe pse Statuti i KUW përcakton pasqyrimin e tyre, si dhe shqyrtimi i dosjeve të aplikantëve e pranimi i studentëve nuk është realizuar nga struktura përgjegjëse e parashikuar në aktet rregullatore.
12. Mungon një Sistem i Menaxhimit të Informacionit për stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi.
13. Mungon një ambient i veçantë për aktivitetin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore. Duke patur në konsideratë faktin që në këtë zyrë janë të arkivuara informacione dhe dosje të rëndësishme të institucionit, në të nuk duhet të kenë akses studentë apo punonjës të tjerë. Gjithashtu, mendojmë se Këshillimi i Karrierës dhe Jetës Studentore duhet të operojë e ndarë dhe në autonomi nga Zyra e Burimeve Njerëzore.

**Rekomandime:**

1. Institucioni, të kryejë një studim të mirëfilltë të tregut të punës, me një metodologji të qartë lidhur me mënyrën e mbledhjes dhe analizmit të të dhënave, në të cilin të reflektohen me evidenca nevojat konkrete të bizneseve në vend si dhe kërkesat e studentëve për fushën e thellimit të njohurive të tyre të mëtejshme për të mundësur aftësi konkuruese në treg.
2. Institucioni, të rishikojë kategorizimin e lëndëve sipas veprimtarive formuese, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, dhe rëndësinë konkrete të lëndëve, si dhe tu ofrojë studentëve mundësinë e përzgjedhjes së lëndëve me zgjedhje. Gjithashtu, sugjerohet përfshirja e ndonjë

moduli/lënde në gjuhën angleze, me qëllim thithjen e studentëve të huaj si dhe rritjen e mobilitetit në kuadër të ndërkombëtarizimit institucional.

3. Institucioni, të marrë masa për përcaktimin si titullarë lëndësh në këtë program studimi, të anëtarëve të personelit akademik që i përkasin kategorisë “Profesor”, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
4. Institucioni, të hartojë raporte analitike të detajuara mbi:
   - arritjet dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit në rang departamenti/programi;
   - cilësinë e studentëve të regjistruar në këtë program studimi;
   - efektivitetin financiar dhe planin për mbështetjen financiare, referuar kohës së këtij cikli studimi 2 vjeçar.

   Në këto raporte sugjerohet të përfshihen mangësitë dhe dobësitë e evidentuara, por dhe përfitimet nga aktivitetet e suksesshme institucionale, për të mundësuar parashikimin e një plan programi për adresimin e përmirësimit të tyre në të ardhmen.
5. Institucioni, të parashikojë një plan-buxhet me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe kriteret e financimit të aktiviteteve kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik të këtij programi studimi, si dhe të realizojë një procedurë transparente për alokimin e fondeve për kërkimin shkencor. Gjithashtu, institucioni, të hartojë politika më gjithëpërfshirëse motivuese e stimuluese për stafin akademik dhe studentët e këtij programi, drejt një kërkimi shkencor të vazhdueshëm, duke mos e limituar vetëm me mundësitë institucionale, por zgjeruar edhe me pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare dhe publikime në revista shkencore prestigjoze jashtë vendit.
6. Institucioni, të rrisë bashkëpunimet me institucionet homologe jo vetëm në kuadër të kërkimit shkencor, por dhe t’i shtrijë ato edhe me fokus mobiliteti të personelit akademik për shkëmbim të eksperiencave në mësimdhënie, si dhe të studentëve të këtij programi studimi. Gjithashtu, rekomandohet që institucioni të organizojë edhe konkurse të formatit Start-up weekends, ku studentët të mund të prezantojnë idetë e tyre inovative.
7. Institucioni, të integrojë mekanizma për mbrojtjen e pronësisë intelektuale në detyrat e kursit dhe punimet e tezës së diplomimit të studentëve, si dhe në botimet e revistës institucionale “Wisdom”.
8. Institucioni, të sigurojë simetrinë e informacionit të pasqyruar si dhe të korrigjojë problemet drejshkrimore e teknike në disa prej rregulloreve të tij.
9. Institucioni, të përditësojë literaturën e parashikuar në syllabuset e këtij programi studimi, me botime të pesë viteve të fundit, si dhe të pasurojë bibliotekën e Institucionit me një gamë më të gjerë botimesh bashkëkohore (libra, revista shkencore e periodikë) në gjuhën shqipe dhe angleze, relevante për programin e studimit.
10. Institucioni, të pajisë laboratorin e teknologjisë me programe (software) të përpunimit dhe analizimit të të dhënave për të rritur cilësinë e kërkimit shkencor në institucion.
11. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë rekomandohet të:

- përfshijë një ekspert të jashtëm si anëtar të njësisë, për të siguruar kryerjen e funksioneve të sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi;
- përdorë instrumenta kuantitativë në mbledhjen e të dhënave për vlerësimet, në mënyrë që njësia të mund të dalë në konkluzione të sakta dhe të pa manipulueshme;
- bëjë pyetësorët pjesë të analizës periodike të mbarëvajtjes së programit të studimit dhe t'jua bëjë të ditura konkluzionet e tyre edhe studentëve.

12. Institucioni:
    - të vendosë e bëjë publike kritere specifike dhe të veçanta në përzgjedhjen e kandidatëve që vijnë nga fusha studimi jo ekonomike apo menaxheriale;
    - të përcaktojë kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme në rregulloret e tij, si dhe ti bëjë ato publike për studentët;
    - të zbatojë procedurat e parashikuara në aktet e brendshme rregullatore lidhur me përzgjedhjen dhe pranimin e studentëve, si psh. ngritja e Komisionit të Pranimit.
13. Institucioni, të implementojë Sistemin e Menaxhimit të Informacionit pasi ai siguron akses në informacione dhe dokumenta si për stafin, ashtu edhe për studentët e këtij programi studimi. Gjithashtu, Institucioni, të publikojë në faqen zyrtare te gjitha informacionet edhe në gjuhën angleze, si dhe të arkivojë dhe publikojë në ëeb edhe aktivitetet e zhvilluara në institucion për orientim drejt tregut të punës, si dhe oferta punësimi lidhur me fushën e studimit.
14. Institucioni, të mundësojë operimin e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore në mënyrë të pavarur dhe në autonomi nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe të sigurojë një ambjent të veçantë për realizimin e aktivitetit të kësaj të fundit. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore të planifikojë dhe organizojë në mënyrë të vazhdueshme aktivitete informuese dhe orientuese në lidhje me punësimin e studentëve.
15. Institucioni, të sigurojë përfshirjen e studentëve në diskutime dhe detyra konkrete në procese vendimmarrje lidhur me programin e studimit, si psh. në borde të tilla si Këshilli i Etikës, procesin e hartimit të RVB-së, etj.

**Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program**

**Master of Science in "Business Administration", offered by "WISDOM" University College**

**Strengths and affirmations:**

1. Orientation towards students support from the moment of enrolment until their graduation.
2. Good education and experience of the staff engaged in the program, are an added value for the study program.
3. Online availability of library resources for students and academic staff.

**Weaknesses:**

1. There is a lack of a thorough study of the labor market to analyze the needs of the labor market today and the identification of those new modules/subjects that would enrich the curriculum of the study program. The methodology on which this study is built fails to reflect the problems and needs of the country's businesses, as evidence from primary or secondary data collected by the market is not reflected, and can not identify needs for knowledge, skills, abilities and market competencies and facilitate student employment.
2. Not full compliance of DCM no. 41, dated 24.1.2018, amended, for the provision of elective courses which, despite the fact that the curriculum results in elective courses, are currently offered as compulsory courses, thus limiting the diversification of knowledge according to students' preferences. There is also lack of any of the courses taught in English language.
3. Most of the head of courses/modules (with the exception of the "Operations Management" and "MIS" courses) do not belong to the category "Professor", as provided in Article 59, point 3, of Law 80/2015.
4. Analytical reports and processed quantitative data to analyze the quality assurance in teaching for the MSHAB *study program* are missing regarding to:
   - achievements and fulfilment of its objectives;
   - the quality of students enrolled in the program. There is no analysis of the quality or reasons for students leaving, and there is a decrease in the average grade of student entry from the academic year 2018-2019 (7) to 2019-2020 (6.5);
   - financial effectiveness and financial support plan referring to the duration period of this 2-year study cycle.
5. Lack of a detailed budget plan with relevant items to support training and funding criteria for research/scientific activities for the professional development of academic staff, and there is no transparent procedure for the allocation of funds within research.
6. Low level of students` knowledge on research methods and low involvement of

academic staff and students in scientific activities and publications. Mechanisms for the protection of intellectual property are lacking, both in the course assignments and students' graduation thesis, and also in the publications of the institutional journal "Wisdom".

7. Spelling and technical problems in some of the regulations, such as Regulation of the Study Program. There is also inconsistency between different regulations such as *"Exam results are recorded and submitted to the secretary within 5 days"* (article 20, point 2 of the program regulation) and *"15 days from the exam date"* (article 26 of the teaching secretariat regulation).
8. Limitation of the physical fund of the library both in number and new publications.
9. Missing Software programs in computer labs, such as SPSS, SAS, etc.
10. Lack of involvement of independent staff and student representatives to perform quality assurance functions with integrity and independence.
11. There are no specific criteria in the selection of students coming from other fields of study, there is a lack of procedures for the recognition of previous qualifications or partial studies in the regulations of the department and the program, although the Statute of KUW stipulates their reflection, and also the review of the applicants' files as well as the admission of students is not done by the responsible unit provided in the regulation acts.
12. Lack of Information Management System for the academic staff and students of this study program.
13. Lack of a separate office for the activities of the Human Resources, Career Counselling and Student Life office. Considering the fact that important information and files of the institution are archived in this office, students or other employees should not have access to it. Meanwhile, Career and Student Life Counselling should operate separately and autonomously from the Office of Human Resources.

**Recommendations:**

1. Institution, has to conduct a thorough labor market study, with a clear methodology regarding the way of data collection and analysis, in which to reflect evidences for concrete needs of businesses in the country and the need for students to deepen their knowledge in order to be competitive in the labor market.
2. Institution, has to review the categorization of courses offered in order to ensure compliance with DCM No. 41, dated 24.01.2018, amended, by re-evaluating the compulsory courses, as well as to offer students the opportunity to select elective courses. It is also suggested to include in the program of study any course/module taught in English language, in order to attract foreign students and increase mobility in the framework of institutional internationalization.
3. Institution, has to take measures for determining as head of courses/modules in this study program, academic staff that belongs to the category "Professor", in accordance with the legal provisions in force.

4. Institution, has to compile detailed analytical reports on:
    a. achievements and fulfillment of the objectives of the study program at the department/program level;
    b. the quality of students enrolled in this study program;
    c. financial effectiveness and financial support plan, referring to the duration period of this 2-year study cycle.

    These reports are suggested to include the identified shortcomings and weaknesses, but also the benefits from successful institutional activities, in order to be able to forecast a program plan to address their future improvement.
5. Institution, has to provide a budget plan with the relevant items to support training and funding criteria for research/scientific activities for the professional development of the academic staff of this study program, as well as to implement a transparent procedure for the allocation of funds for research purposes. Also, the institution, has to design more comprehensive motivational and stimulating policies for the academic staff and students of this program, towards a continuous scientific research, not only limiting it with institutional possibilities, but also expanding it by participating in international conferences and publications in scientific prestigious journals abroad.
6. Institution, has to increase cooperation with counterpart institutions focusing not only in research but also mobility activities, to increase exchange experiences of academic staff in teaching, and also of the students of this study program. Also, it is recommended that the institution organizes competitions in the format of Start-up weekends, where students can present their innovative ideas.
7. Institution, has to integrate mechanisms for the protection of intellectual property in student's course work and graduation thesis, and also in the publications of the institutional magazine "Wisdom".
8. Institution, has to ensure information symmetry as well as to correct the spelling and technical problems found in some of its regulations.
9. Institution, has to update the literature provided in the syllabi of this study program, with publications of the last five years, as well as to enrich the library of the Institution with a wider range of contemporary publications (books, scientific journals and periodicals) in Albanian and English language, relevant to the study program.
10. Institution, has to equip the computer labs with software for data processing and analysis in order to increase the quality of scientific research in the institution.
11. The Internal Quality Assurance Unit is recommended to:
    - involve an external expert as a member of the unit, to ensure the implementation of quality assurance functions with integrity and independence;
    - use quantitative instruments in data collection of performance evaluations, so that the unit can come to accurate and non-manipulative conclusions;
    - make the questionnaires part of the periodic analysis of the progress of the study program, and to make known their conclusions to the students too.
12. Institution, has to:

- establish and make public the specific and special criteria in the selection of candidates coming from the field of non-economic or managerial studies;
- define the criteria and procedures for the recognition of previous qualifications or partial studies in its regulations, as well as to make them public for students;
- implement the procedures provided in the internal regulatory acts related to the selection and admission of students, such as setting up the Admission Commission.

13. Institution, has to implement the Information Management System since it provides access to information and documents for both staff and students of this study program. Also, the Institution, has to publish all the information in the official website in English language too, and to archive and publish also on the web the activities developed in the institution for orientation towards the labor market, as well as employment offers related to the field of study.
14. Institution, has to enable the operation of Career and Student Life Counseling independently and autonomously from the Human Resources Office and to provide a separate space for each of them. Career and Student Life Counseling should continuously plan and organize information and orientation activities related to student employment.
15. Institution, has to ensure the inclusion of student's representatives in discussions and decision-making processes, with specific tasks related to the study program, for example including them as board members such as in the Ethics Council, in the drafting process of the SER, etc.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. Dr. Alba Kruja
2. PhD. Eriona Shtëmbari

## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | X | |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | X | |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | X | |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | X | |